

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 1353 Rep.

NR. 308 Kol.

## KONTRATË KONÇESIONI

e llojit "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim)

për

"Dhënie me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë"

Në Tiranë, më datë 26.04.2016, para meje Demisa M. Cela, Noter/e, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rr. Breshit Follakeu paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Bashkia e Tiranës**, e përcaktuar si Autoriteti Kontraktues për dhënien me koncesion të parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 23.07.2008, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj, (referuar në vijim si "BT");

dhe

**Shoqëria "Taiwan" sh.p.k.**, me seli në Rruga Ibrahim Rugova, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, Tiranë dhe NIPT K32022001U, e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, Z. Avni Braçaj, në Tiranë, (referuar në vijim si "Konçesionari"), madhor dhe me zotësi të plotë ligjore për të vepruar (referuar në vijim si "Konçesionari").

BT dhe Konçesionari në vijim sipas kontekstit do të referohen bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala".

### Kushte paraprake

#### A. Duke pasur parasysh se Bashkia e Tiranës:

- Është e interesuar për rregullimin e situatës së parkimit në qytetin e Tiranës duke zhvilluar politika transporti dhe parkimi të cilat ndihmojnë qytetarët në lëvizjen brenda dhe jashtë qytetit.
- Konsideron ndërtimin e parkimeve nëntokësore, si një element të rëndësishëm të politikës së Transportit dhe parkimit në Tiranë.



- c) Vlerëson formën BOT të koncesionit si një formë që bën të mundur, stimulimin e investitorëve privat dhe bashkëpunimin me sektorin publik për ndërtimin e parkimeve nëntokësore me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 29.09.2008 për *“Përcaktimin e formës së dhënies me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”*.
- d) BT harton Raportin Përmbledhës me nr.prot. 4663, datë 20.05.2009 mbi *“Vlerësimin e ofertave për “Dhënie me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë”* dhe pranon ofertën e paraqitur nga Koncesionari.
- e) BT me shkresës nr./prot. 4207, datë 06.05.2009, të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, drejtuar shoqërisë “Taiwan” shpk, për *“Njoftim mbi vlerësimin dhe klasifikimin e shoqërisë”* njofton fitues Koncesionarin.
- f) Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 30.9.2015 *“Për shfuqizimin e vendimit nr. 1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”*, BT rimerr përgjegjësinë e administrimit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë.
- g) Me Vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 67, datë 30.12.2015 për *“Miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare mbi parkimin nëntokësor në parkun “Rinia”, BT ndër të tjera miraton përdorimin e truallit për projektin koncesionar.*
- h) Me shkresën nr.prot. 22257, datë 23.12.2015, Bashkia Tiranë i ka komunikuar Koncesionarit fillimin e negociatave.
- i) Me shkresën nr.prot.22257/1, datë 29.12.2015 shoqëria “Taiwan” shpk shpreh vullnetin e saj për të vazhduar më tej procedurat dhe propozn draft/kontratën për t’u shqyrtuar nga BT.

#### **B. Duke pasur parasysh se Koncesionari:**

- a) Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e parkimit nëntokësor të sipërpërmendur, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
- b) Është i interesuar të investojë në ndërtimin e parkimit nëntokësor me qëllim ofrimin e këtij shërbimi.
- c) Zotëron kapacitetet tekniko financiare për të realizuar projektin e miratuar sipas kësaj kontratë si dhe zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**Palët lidhin këtë kontratë koncesionare bazuar në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”, i ndryshuar; nenin 48 të Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Vlerësimit dhe të Dhënies së Koncesioneve”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 23.07.2008 “Për Përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënie me Koncesion të Parkimit Nëntokësor në Parkun “Rinia”, dhe Miratimin e Bonusit në Procedurën Përzgjedhëse Konkurruese që i Jepet Shoqërisë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 30.12.2015 për “Miratimin e Termave Kryesore të Kontratës Koncesionare mbi Parkimin Nëntokësor në Parkun “Rinia”, dhe bien dakord për sa më poshtë:**



## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizime dhe Interpretime

1.1 Në këtë Kontratë, fjalët dhe shprehjet në vijim do të kenë, përveçse kur janë të huaja për kontekstin apo kuptimin e atjeshëm, kuptimin që u është dhënë atyre përkatësisht në vazhdim:

- (a) "**Barrë**" nënkupton çdo hipotekë, peng, barrë siguroese, privilegj, përparësi, cedim, kompensim ose barrë të tjera siguroese të çdo lloji apo çdo kontratë ose rregullim tjetër, që vendos garanci mbi ose në lidhje me çdo aktiv të tashëm ose të ardhshëm të ardhura ose të drejta mbi Mjedisin e Projektit.
- (b) "**Certifikata e Përmbushjes**" nënkupton certifikatën e lëshuar nga Inxhinieri i Pavarur në përputhje me Nenin 10.2.4.
- (c) "**Data e Fillimit**" nënkupton datën në të cilën zotërimi fizik i Vendndodhjes së Projektit i jepet Koncesionarit nga BT, dorëzim i cili vërtetohet me mbajtjen nga palët të Vërtetimit të Dorëzimit, sipas Shtojcës 5.
- (d) "**Dokumentet e Financimit**" nënkupton dokumentet e përmbushura ose që do të përmbushen nga Koncesionari në lidhje me ndihmesën financiare (përfshirë ri-financimin) për Projektin që duhen siguruar nga Palët Financuese me anën e huave, paradhënieve, plotësimit të obligacioneve dhe instrumenteve e garancive të tjera për borxhin, ndarjes së riskut, zotimit për financim, apo çfarëdo forme tjetër të rritjes së kreditit dhe përfshin kontratën e huasë, kontratën e garancisë dhe çdo dokument tjetër që ofron siguri për këtë ndihmesë financiare, si edhe përfshin shtesat dhe ndryshimet e bëra në të.
- (e) "**DOT**" nënkupton Datën e Operacioneve Tregtare të projektit që do të jetë data në të cilën Inxhinieri i Pavarur ka lëshuar Certifikatën e Përmbushjes, pas përfundimit të ndërimit të Projektit dhe që do të jetë subjekt i dispozitave të kësaj Kontratë.
- (f) "**Kontrata**" nënkupton këtë kontratë koncesioni, shtojcat, dhe çdo dokument tjetër që do të lidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
- (g) "**Kërkesat Minimale të Operimit dhe Mirëmbajtjes**" nënkupton përcaktimet e parashikuara në Shtojcën 7.
- (h) "**Inxhinieri i Pavarur**" nënkupton subjektin e caktuar në përputhje me Nenin 7.1
- (i) "**Legjislacioni i Zbatueshëm**" nënkupton të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH që ndikojnë direkt apo indirekt në këtë projekt koncesionar.
- (j) "**Lejet e Zbatueshme**" nënkupton të gjitha lejet, licencat, autorizimet, pëlqimet dhe miratimet sipas apo në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, përveç lejes Zhvillimore, të kërkuara për t'u marrë nga Koncesionari, me qëllim që të vërë në jetë Projektin dhe ofrojë Mjedisin e Projektit në përputhje me këtë Kontratë.
- (k) "**Llogaritja e afateve**" kur afati është i caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit



që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në fund të muajit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit.

- (l) "**Manuali i Mirëmbajtjes**" ka kuptimin që i jepet në Nenin 10.5 të Kontratës.
- (m) "**Marrëveshja Financiare**" nënkupton datën në të cilën Dokumentet e Financimit që sigurojnë financimin nga Palët Financuese janë bërë efektive dhe Koncesionari, ka akses të menjëhershëm në financime të tilla sipas Dokumenteve të Financimit.
- (n) "**Mbikqyrësi i Operimit**" nënkupton subjektin e caktuar në përputhje me Nenin 7.2
- (o) "**Mjedisi i Projektit**" nënkupton bashkërisht mjediset në Vendndodhjen e Projektit që do të ndërtohen, mbështeten, instalohen, ngrihen apo sigurohen nga Koncesionari për përdorimin e parkingut nëntokësor duke vënë në jetë Projektin dhe në mënyrë më të hollësishme të parashikuara në Shtojcën 2 dhe 5.
- (p) "**Mosmarrëveshje**" do të ketë kuptimin që i jepet në Nenin 20.
- (q) "**Ndryshime në Ligji**" nënkupton ndodhjen e cilësdo nga sa vijon pas datës së kësaj Kontrate: (a) miratimin e çfarëdo ligji të ri shqiptar dhe/ose akti nënligjor; (b) shfuqizimin, ndryshimet apo shtesat e çfarëdo ligji shqiptar ekzistues dhe/ose akti nënligjor.
- (r) "**Nënkontraktues**" nënkupton Personin me të cilin Koncesionari ka lidhur ose mund të lidhë kontratë, për zbatimin e cilësdo pjesë të Projektit.
- (s) "**Ngjarje e Forcës Madhore**" do të ketë kuptimin që i jepet në Nenin 11.
- (t) "**Pala Financuese**" nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit, sipas cilitdo nga Dokumentet e Financimit.
- (u) "**Pasojë e Padëshiruar Materiale**" nënkupton pasojën e padëshiruar materiale mbi (a) aftësinë e Koncesionarit për të respektuar dhe përmbushur cilëndo nga të drejtat dhe detyrimet e tij sipas dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontratë dhe/ose (b) ligjshmërinë, vlefshmërinë, karakterin detyrues apo zbatueshmërinë e kësaj Kontrate.
- (v) "**Praktika të Mira Industriale**" nënkupton ato praktika, metoda, teknika, standarde, aftësi, përkushtime dhe kujdes të cilat priten përgjithësisht dhe arsyeshmërisht si edhe pranohet ndërkombëtarisht nga një operator arsyeshmërisht i aftë dhe me përvojë i përfshirë në të njëjtin lloj sipërmarrje siç përcaktohet sipas kësaj Kontratë si edhe nënkupton praktika të mira inxhinierike në projektimin, manovrimin, ndërtimin dhe menaxhimin e projektit dhe që pritet të sjellë si pasojë përmbushjen nga ana e Koncesionarit, të detyrimeve të tij e operimin dhe mirëmbajtjen e Projektit në përputhje me këtë Kontratë, Legjislacionin e Zbatueshëm, lejet e zbatueshme, sigurimin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë dhe efikasitetin.
- (w) "**Periudha e Faljes**" nënkupton periudhën kohore të përcaktuar në Nenin 18.1 të Kontratës që i është caktuar Koncesionarit për eliminimin e mospërmbushjeve të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, gjatë së cilës nuk zbatohen sanksione/penalitetet ndaj Koncesionarit.
- (x) "**Periudha e Koncesionit**" ose "**Kohëzgjatja e Koncesionit**" do të ketë kuptimin e përcaktuar në Nenin 2.5.1 të Kontratës.
- (y) "**Periudha e Operimit**" nënkupton periudhën që nis që nga DOT dhe që mbaron me përfundimin e Periudhës së Koncesionit.



- (z) "**Periudha e Rregullimeve**" nënkupton periudhën e përcaktuar me hollësi në këtë Kontratë për të eliminuar çdo shkelje, mospërbushje apo pakujdesi në lidhje me cilëndo dispozitë të kësaj Kontratë nga Pala përgjegjëse për një shkelje, mospërbushje apo pakujdesi të tillë.
- (aa) "**Periudha e Zbatimit**" nënkupton periudhën që nis nga Data e Fillimit dhe mbaron në DOT.
- (bb) "**Projekte**" nënkupton të gjitha skicimet, projektet, përlllogaritjet dhe dokumentet që i përkasin Projektit siç përcaktohet në Shtojcën 2 dhe do të përfshijnë skicimet "sipas ndërtimit" të Projektit.
- (cc) "**Programi i Përfundimit të Projektit**" nënkupton etapat progresive të Projektit, të përcaktuara në Shtojcën 2 dhe 3 për vënien në jetë të Projektit.
- (dd) "**Prova dhe Testimet**" nënkupton provat që do të kryhen sipas përcaktimeve të bëra në këtë kontratë dhe siç parashikohet në Shtojcën 4.
- (ee) "**Punimet e Ndërtimit**" nënkupton të gjitha punimet dhe veprimet e nevojshme për të filluar operimin tregtar të Projektit në përputhje me këtë Kontratë.
- (ff) "**Tarifa Koncesionare**" është tarifa që Koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktues, për përdorimin e pronës publike.
- (gg) "**Tarifë Parkimi**" nënkupton tarifën e parkimit nëntokësor që do të vendoset për një automjet që përdor Mjedisi e Projektit, sipas parashikimeve të paraqitura në Shtojcën 1.
- (hh) "**Shkelje Materiale**" nënkupton një shkelje nga secila Palë të cilitdo nga detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, e cila ka shumë të ngjarë të ketë një Pasojë të Padëshiruar Materiale mbi Projektin dhe që kjo Palë nuk ka arritur ta rregullojë brenda Periudhës së Rregullimeve.
- (ii) "**Sigurimi i Kontratës**" vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e mospërbushjes së detyrimeve të kontratës nga Koncesionari, siç përcaktohet në Nenin 3.
- (jj) "**Specifikimet Teknike dhe Standartet**" nënkupton përcaktimet e hollësishme në lidhje me kërkesat teknike dhe standartet e operimit të Projektit siç parashikohet në dokumentat standad të tenderit, në ofertë apo çdo ndryshim ose shtesë në to e paraqitur nga Koncesionari dhe e miratuar nga BT.
- (kk) "**Shoqëria Koncesionare**" do të quhet shoqëria e themeluar nga Koncesionari në përputhje me parashikimet e nenit 5.1.1 të kësaj Kontrate.
- (ll) "**Shpenzimet e Ekspertëve**" nënkupton të gjitha pagesat e drejtpërdrejta dhe shpenzimet në lidhje me ekspertët, duke përfshirë por pa u kufizuar në Inxhinieri i Pavarur, Mbikqyrësi i Operimit, dhe të tjerë, të cilat do të mbulohen nga Shoqëria Koncesionare dhe do të përfshihen si shpenzime të kësaj të fundit.
- (mm) "**Vendndodhja e Projektit**" nënkupton veçoritë e pasurisë së paluajtshme të përcaktuara në Shtojcën 5 në të cilën do të zbatohet Projekti dhe do të sigurohet Mjedisi i Projektit në përputhje me këtë Kontratë.
- (nn) "**Vlera e Riinvestimit**" do të konsiderohet vlera e investimit për rikonstruksionin që do të kryejë investitori para përfundimit të afatit të koncesionit, sipas nenit 2.4.
- (oo) "**Vit Financiar**" nënkupton vitin financiar që fillon që nga 1 Janari i çdo viti kalendarik dhe mbaron në datën 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.



1.2 Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:

- (a) njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas.
- (b) referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër.
- (c) çdo frazë që fillon me fjalët "*duke përfshirë*", "*përfshin*", "*në veçanti*", "*për shembull*", të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura.
- (d) titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Shtojcat dhe tabela e përmbajtjes, janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.
- (e) referimet në dispozitat dhe Shtojcat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe Shtojcat e kësaj Kontrate.
- (f) pa cënuar parashikimin e paragrafit të mësipërm, nëse ka konflikte apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Shtojcave dhe/ose ndonjë shtojcë të Shtojcave dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:
  - kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese (DST dhe oferta e Konçesionarit) dhe nenin 2.3.1 dhe 2.5.1 të kësaj Kontrate;
  - dispozitat e kësaj Kontrate;
  - çdo Shtojcë tjetër dhe shtojcat e tyre;
  - çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.



## KREU II DHËNIA E KONÇESIONIT

### Neni 2 Objekti i Konçesionit

#### 2.1 Objekti

Objekti i kësaj Kontrate konçesioni është ndërtimi, operimi dhe transferimi i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë, konform termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.

#### 2.2 Dhënia e Konçesionit

Në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuar në këtë Kontratë, BT i jep dhe autorizon Konçesionarin të drejtën e vetme dhe ekskluzive që të financojë, ndërtojë, operojë dhe mirëmbajë Mjedisin e Projektit dhe të ushtrijë e/ose të gëzojë të drejtat, fuqitë, privilegjet, autorizimet dhe titujt siç parashikohen në këtë Kontratë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në të drejtën për të kërkuar dhe mbledhur Tarifën e Parkimit për përdorimin e Projektit/Mjedisit të Projektit, apo cilëndo pjesë të tij (në tërësi "**Konçesioni**").

#### 2.3 Tarifa Konçesionare



- 2.3.1 Koncesionari do t'i paguajë BT këtë Tarifë Koncesionare: 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të fitimeve neto (pas tatimit), bazuar mbi pasqyrat financiare të audituara dhe të miratuara të Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit Financiar.
- 2.3.2 Koncesionarit detyrimi për t'i paguar BT-së Tarifën Koncesionare i lind duke filluar nga data në të cilin ndodh DOT deri në përfundim të Periudhës së Koncesionit.
- 2.3.3 Tarifa Koncesionare do të paguhet në këste 4 (katër) mujore brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës, duke u bazuar në deklarinim mujor të kryer nga Shoqëria Koncesionare pranë insitucioneve tatimore sipas Ligjit të Zbatueshëm.
- 2.3.4 Me mbylljen e Vitit Financiar dhe miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë Koncesionare, Palët do të bëjnë rakordimet e Tarifës Koncesionare për të shmangur çdo pagesë të shtuar apo munguar të kësaj tarife. Rakordimet do të kryhen brenda dhe jo më vonë datës 30 (tridhjetë) Prill të Vitit Financiar pasardhës.
- 2.3.5 Të gjitha pagesat do të kryhen përmes një urdhri bankar të Koncesionarit në favor të llogarisë bankare të BT, në degën e Thesarit e cila do t'i komunikohet në vijim Koncesionarit.
- 2.3.6 Përveç sa parashikohet nga Neni 12 në vazhdim, çdo pagesë e vonuar sipas këtij paragrafi përbën shkelje të detyrimit të Koncesionarit dhe i nënshtrohet dëmshpërblimeve për vonesën në pagesa si vijon:
- një interes 4 (katër) mujor në masën 10% të shumës së papaguar do të zbatohet për çdo pagesë të vonuar.

## **2.4 Vlera e Riinvestimit**

Duke filluar nga viti i 28-të nga DOT, Koncesionari do të riinvestojë në masën 20% (njëzet përqind) për pajisjet dhe 5% (pesë përqind) për ndërtesën, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim në vijim. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

## **2.5 Kohëzgjatja e Koncesionit**

- 2.5.1 Koncesioni i dhënë është për një periudhë prej 30 (tridhjetë) vitesh duke nisur nga Data e Fillimit periudhë gjatë së cilës Koncesionari është i autorizuar të zbatojë Projektin dhe të operojë Mjedisin e Projektit në përputhje me këto dispozita.
- 2.5.2 Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:
- (a) Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet Forca Madhore, Periudha e Koncesionit dhe afatet përkatëse, do të zgjaten në përputhje me kohën e duhur që Projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm, kur rentabiliteti është totalisht i lidhur me



Forcën Madhore, në përputhje me analizat financiare apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme, përveçse kur Konçesionari nuk e kërkon këtë zgjatje.

- (b) Palët bien dakord se Periudha e Konçesionit do të zgjatet në rastin e një ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që kalon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.
- (c) në rast se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të Kontratës, BT vlerëson se është në pamundësi për transferimin e operimit apo një ngjarje tjetër në interes publik, me pëlqimin e Konçesionarit mund të zgjasë për një afat të arsyeshëm vetëm vazhdimin e operimit nga Konçesionari. Kjo zgjatje nuk do të pengojë në asnjë rast transferimin e Mjedisit të Projektit në pronësi të BT-së.
- (d) Rastet të veçanta të zgjatjes së Periudhës së Konçesionit do të jenë si më poshtë vijon:
  - (i) nëse vonesat e institucioneve/enteve publike, në lidhje me lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit të nevojshme për Konçesionarin me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate, zgjasin më shumë se një periudhë 60 (gjashtëdhjetë) ditë, atëherë do të kemi zgjatje të Datës së Programuar të Përfundimit të Projektit për të njëjtën periudhë;
  - (ii) nëse vonesat e institucioneve/enteve publike, në lidhje me lëshimin e lejeve përkatëse dhe të nevojshme për Konçesionarin me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate, zgjasin më shumë se një periudhë 6 (gjashtë) mujore, atëherë do të kemi zgjatje të Afatit Konçesionar dhe afateve përkatëse për të njëjtën periudhë;
  - (ii) nëse gjatë zhvillimit të punimeve në Vendndodhjen e Projektit, zbulohen relike kulturore, arkeologjike, fosile, tuma varrezash dhe përmendore, mbetje të kaluara artistike dhe çdo send tjetër me vlerë arkeologjike, gjeologjike dhe historike, që sjell nevojën e gërmimeve arkeologjike, që shkaktojnë ndërprerje të punimeve nga Konçesionari, për më shumë se një periudhë 6 (gjashtë) mujore, atëherë do të kemi zgjatje të Afatit Konçesionar për të njëjtën periudhë.

2.5.3 Në rast zgjidhje të Kontratës, Periudha e Konçesionit nënkupton dhe do të kufizohet në periudhën që nis nga Data e Fillimit dhe mbaron me zgjidhjen e saj.

2.5.4 Mbarimi i Kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj BT-së dhe të tretëve.

## 2.6 Pranimi i Konçesionit

Konçesionari pranon Konçesionin dhe bie dakord e merr përsipër të vërë në zbatim Projektin/Mjedisin e Projektit, si edhe të përmbushë /plotësojë të gjitha detyrimet e tij në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara në këtë Kontratë.





## 2.7 Financimi

### 2.7.1 Mënyrat e financimit të Projektit

- (a) Konçesionari, me kostot, shpenzimet dhe riskun e tij, duhet të sigurojë financimet e nevojshme për zbatimin në kohë të Projektit.
- (b) Në rast se Konçesionari do të përdorë fonde të marra hua nga Palët Financuese për të financuar Projektin, do të zbatohen përcaktimet e Legjislacionit të Zbatueshëm.
- (c) Konçesionari, brenda 7 (shtatë) ditësh nga arritja e Marrëveshjes Financiare, do t'i paraqesë BT-së setin e Dokumentave të Financimit, që provojnë lidhjen e Marrëveshjes Financiare.

### 2.7.2 Ndryshimet e Dokumenteve të Financimit

- (a) Palët bien dakord që për çdo shtesë që bëhet në Dokumentet e Financimit, Konçesionari do të njoftojë me shkrim BT.
- (b) Palët bien dakord që për çdo amendim (shtesë apo ndryshimi) të marrëveshjes/ve siguruese apo instrumentave garantues pjesë e Dokumenteve të Financimit do t'i njoftohet BT-së.

### 2.7.3. Cashflow

Palët bien dakord që, pavarësisht nga sa më sipër, barrët siguruese apo çdo instrument tjetër garantues që do të vendosen mbi të ardhurat në para të Projektit/Cashflow si pjesë e një operacioni financimi - i cili mund të ndodhë në cilindo moment qoftë gjatë Periudhës Konçesionare - do të përjashtojnë shprehimisht dhe në asnjë rast nuk do të çënojnë/prekin Tarifën Konçesionare.

## 2.8 Vendndodhja e Projektit

- 2.8.1 BT merr përsipër që të dorëzojë tek Konçesionari zotërimin fizik të Vendndodhjes së Projektit të lirë nga çdo barrë, dhe pa asnjë defekt apo të metë, bashkë me të gjitha të drejtat e nevojshme për Konçesionarin për të vënë në zbatim Projektin, në përputhje me këtë Kontratë. Dorëzimi i Vendndodhjes së Projektit do të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Për këtë qëllim, Palët bien dakord të nënshkruajnë një vërtetim dorëzimi sipas Shtojcës 5 bashkëngjitur kësaj Kontrate.
- 2.8.2 BT pohon se pasi Vendndodhja e Projektit t'i dorëzohet në përputhje me nën-paragrafin e mëparshëm 2.8.1, Konçesionari do të ketë të drejtën ekskluzive që të hyjë, marrë në posedim, përdorë Vendndodhjen e Projektit dhe të përballojë me shpenzimet e tij



zhvillimet dhe përmirësimet e Vendndodhjes së Projektit, siç mund të jetë e nevojshme apo e përshtatshme për të zbatuar Projektin dhe për të siguruar Mjedisin e Projektit sipas dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

2.8.3 Konçesionari nuk do ta përdorë Vendndodhjen e Projektit për asnjë qëllim tjetër veç qëllimeve të parashikuara në këtë Projekt dhe qëllimeve të tjera që lidhen ngushtësisht me to.

## 2.9 Posedimi i qetë

BT garanton që:

2.9.1 Vendndodhja e Projektit është në përdorim të BT dhe kjo e fundit gëzon tagra që të posedojë, disponojë, administrojë dhe të hyjë në marrëveshje në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

2.9.2 Konçesionari nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë detyrim apo përgjegjësi në lidhje me pagesën e çfarëdo dëmi, qoftë/apo me rehabilitimin dhe rivendosjen e cilitdo Person, nga i cili është marrë Vendndodhja e Projektit apo cilado pjesë e saj, të cilat do të jenë vetëm në përgjegjësinë ekskluzive të BT; dhe

2.9.3 Konçesionari, në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, do të ketë në posedim dhe gëzim të qetë Vendndodhjen e Projektit përgjatë të gjithë Kohëzgjatjes së Konçesionit. Në rastin kur Konçesionari pengohet nga cilido person që pretendon çfarëdo të drejte, titulli apo interesi në apo mbi Vendndodhjen e Projektit apo cilëndo pjesë të saj ose në rastin e çdo veprimi përmbarimor, BT kundrejt pretendimeve dhe procedimeve të tilla do të sigurojë Konçesionarin nga çdo humbje apo dëmtim, i drejtpërdrejtë apo i prejardhur, që Konçesionari mund të pësojë për shkak të çfarëdo të drejte, titulli, interesi apo detyrimi të tillë.

## 2.10 Të drejtat dhe titulli mbi Vendndodhjen e Projektit

2.10.1 Konçesionari gëzon të drejta të plota dhe ekskluzive për përdorimin e Vendndodhjes së Projektit në përputhje me dispozitat e kësaj Kontratë dhe për këtë qëllim, ai mund të vendosë rregulla për hyrjen dhe përdorimin e Mjedisit të Projektit nga palët e treta në diskrecionin e tij.

2.10.2 Konçesionari nuk do të krijojë Barrë mbi të gjithë apo cilëndo pjesë të Vendndodhjes së Projektit, titulli ekskluziv dhe i plotë i së cilës është dhe do të mbetet i BT-së.

## 2.11 Mjedisi i Projektit

2.11.1 Konçesionari do të ketë titull të pakufizuar pronësie mbi Mjedisin e Projektit (ndërtimet e reja) deri në përfundim të Periudhës së Konçesionit dhe mund ta regjistrojë titullin e tij në regjistrat publik në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe këtë Kontratë. Nëse, për

ndonjë arsye Konçesionarit nuk mund të jetë pronar i Mjedisit të Projektit do t'i akordohet uzufukti mbi këto ndërtime/ambiente/pajisje te reja.

- 2.11.2 Konçesionari do të ketë të drejtën e vetme dhe ekskluzive për të përdorur Mjedisin e Projektit (ndërtimet e reja), me përjashtim të personave që i përdorin si klientë, kontraktues apo persona të tjerë që përdorin Mjediset e Projektit pa ndikuar negativisht tek të drejtat e Konçesionarit sipas kesaj Kontrate.
- 2.11.3 Konçesionari do të ketë mundësinë të krijojë peng ose barrë siguroese mbi Mjedisin e Projektit në përputhje me këtë Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshëm.
- 2.11.4 BT nuk do të jetë përgjegjëse dhe nuk do të paguajë asnjë taksë ose kosto dhe shpenzime të tjera në lidhje me pronësinë mbi Mjedisin e Projektit (ndërtimeve të reja).

### Neni 3 Sigurimet

#### 3.1 Sigurimi i Kontratës

- 3.1.1 Konçesionari, për përmbushjen e duhur dhe të përpiktë të detyrimeve të tij gjatë Kohëzgjatjes së Koncesionit, para firmosjes së kësaj kontrate i paraqet BT-së, një garanci nga shoqëria e sigurimit në formën e Sigurimit të Kontratës në shumën prej 193,793,280 (njëqindëntëdhjetetë milion e shtatëqindëntëdhjetetë mijë e dyqindetëdhjetë) Lekë, të barabartë me 10% të vlerës së ofertës të paraqitur nga Konçesionari.
- 3.1.2 Garancia do të jetë e vlefshme deri në datën që përfshin 30 (tridhjetë) ditë nga data e kryerjes së Transferimit të Mjedisit të Projektit, duke respektuar përcaktimet e bëra në Nenin 16.
- 3.1.3 Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Konçesionarit në lidhje me këtë kontratë. Palët bien dakord se Sigurimi i Kontratës do të reduktohet në masën 50% (pesëdhjetë për qind) e shumës së mësipërme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të Çertifikatës së Përmbushjes nga Inxhinieri i Pavarur, shumë e cila do të mbetet e pandryshuar deri në fund të Kohëzgjatjes së Koncesionit.
- 3.1.4 Nëse Sigurimi i Kontratës paraqitet nga një shoqëri sigurimi për një afat të caktuar më të shkurtër sesa Afati i Kontratës, Konçesionari 1 (një) muaj para është i detyruar t'i paraqes BT Sigurimit të Kontratës të ripërtrirë. Dispozitat e përcaktuara në Nenin 3.1.1, 3.1.2 dhe 3.1.3 më lart, do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këtë Sigurim të ri të Kontratës. Në
- 3.1.5 Nëse, për cilindo shkak qoftë, Sigurimi i Kontratës nuk paraqitet në datën e përcaktuar në Nenin 3.1.4 mësipër, BT do të njoftojë menjëherë me shkrim Konçesionarin për vonesën e konstatuar duke i caktuar këtij të fundit një afat prej të paktën 30 (tridhjetë) ditësh për eliminimin e mospërmbushjes dhe të pasojave të saj (nënkupton "Periudhën e Faljes").





Në rast mospërbushjet Konçesionari, do të jetë përgjegjës për vonesën përtej kësaj date dhe do ti paguajë BT një penaltitet prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë në ditë një muaj që fillon nga data e nesërme e përfundimit të Periudhës së Faljes sipas këtij neni.

Në përfundim të kësaj periudhe BT, në diskrecion të saj ka të drejtë, ka të drejtë ose (i) të zgjidhë Kontratën nëpërmjet dhënies së një njoftimi paraprak prej 15 (pësemëdhjetë) ditësh Konçesionarit ose (ii) të vazhdojë të aplikojë një penaltitet prej 20.000 (njëzet mijë) Lekë për maksimumi 1 (një) muaj tjetër dhe, më tej, të zgjidhë kontratën me efekte të menjëhershme.

### 3.2 Risigurimi i Kontratës

3.2.1 Në rastin kur BT e arkëton Sigurimin e Kontratës në përputhje me Njoftimin e Arkëtimit të lëshuar për shkak të mospërbushjes nga Konçesionari të dispozitave të Neneve 3.7, 12, 17, Konçesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Njoftimi i Arkëtimit, do t'i japë BT-së një Sigurim të ri Kontrate për të arritur në të njëjtën vlerë të Sigurimit të Kontratës, sikurse është përcaktuar në nenin e mëparshëm 3.1. Me mos kryerjen e risigurimit të Kontratës, BT do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me dispozitat e Nenit 12. Dispozitat e përcaktuara në Nenin 3.1 më lart, do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këtë Sigurim të ri të Kontratës.

3.2.2 Konçesionari do t'i japë BT një Sigurim të ri Kontrate, sikurse është parashikuar në Nenin 3.2 edhe në rastet e shtyrjes së afatit të kësaj Kontrate, nëse një shtyrje e tillë është parashikuar në dispozitat e kësaj Kontrate.

### 3.3 Sigurimet e tjera

Konçesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave të Konçesionarit dhe përdorimin e Mjedisit të Projektit dhe do t'i përcjellë ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues, kopjet e certifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi të arsyeshëm paraprak, prej Autoritetit Kontraktues.

3.3.1 Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 për "Veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.

Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit apo gjatë operimit të objektit, vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.





3.3.2 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësië jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe jo më të lartë se 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.

#### **3.4 Sigurimi gjatë Periudhës së Zbatimit**

Konçesionari, me kostot dhe shpenzimet e tij, do të blejë dhe mirëmbajë gjatë Periudhës së Zbatimit sigurime të tilla si të jenë të nevojshme, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në sa vijon:

- 3.4.1 Sigurim i gjithë riskut të ndërtimit, punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës;
- 3.4.2 Sigurim të plotë për përgjegjësinë e palës së tretë duke përfshirë këtu dëmtimet apo vdekjen e personave që mund të hyjnë në Vendndodhjen e Projektit/Mjediset e Projektit;
- 3.4.4 Çdo sigurim tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të mbrojtur Konçesionarin, në diskrecionin e këtij të fundit.

#### **3.5 Sigurimi gjatë Periudhës së Operimeve**

Konçesionari, me kostot dhe shpenzimet e tij, do të blejë dhe mirëmbajë përgjatë gjithë Periudhës së Operimeve, polica sigurimi vjetore për t'u mbrojtur kundrejt:

- 3.5.1 Humbjes, dëmtimit apo shkatërrimit të Mjedisit të Projektit, në vlerën e zëvendësimit;
- 3.5.2 Përgjegjësisë së përgjithshme të Konçesionarit që rrjedh nga Konçesioni;
- 3.5.4 Çdo sigurim tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të mbrojtur Konçesionarin në diskrecionin e këtij të fundit.

#### **3.6 Shoqëritë e sigurimit**

Konçesionari do të sigurojë që gjitha pasuritë që janë objekt i sigurimit, të përfshira në Pasuritë e Projektit dhe/ose Mjedisit të Projektit përmes shoqërive të sigurimit të mirënjohura, në masën që sigurimet janë të nevojshme të bëhen përmes tyre.

#### **3.7 Prova e mbulimit me sigurim**

Konçesionari, do t'i sigurojë BT kopje të policave të sigurimit (ose vërtetimet e certifikatat e përshtatshme apo prova të tjera të kënaqshme të sigurimit) të përfuara prej tij, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga data e sigurimit.



#### **4.1 Përlllogaritja, mbledhja dhe përshtatja e Tarifës së Parkimit**

Sipas dispozitave të kësaj Kontratë, Konçesionari, gjatë Periudhës së Operimit, do të ketë të drejtë të përlllogarisë, kërkojë dhe mbledhë Tarifën e Parkimit në përputhje me Shtojcën I.

#### **4.2 Rishikimi i Tarifës së Parkimit**

4.2.1 Me përjashtim të vitit të parë të Periudhës së Operimit, Konçesionari mund t'i kërkojë çdo vit BT-së rishikimin e Tarifës së Parkimit bazuar në:

- (i) ndryshimin e normës së inflacionit në shkallë kombëtare sipas publikime të bëra nga institucioni përgjegjës; si dhe
- (ii) ndryshimeve të arsyetuara të kushteve të tregut.

4.2.2 Koncesionari ka detyrimin të njoftojë me shkrim BT mbi rishikimin e Tarifës së Parkimit dhe masën e propozuar të rishikimit, në përputhje me dispozitat e këtij neni. Palët do të takohen dhe diskutojnë mbi rishikimin e Tarifës së Parkimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

4.2.3 Çdo propozim i ndryshimit të Tarifës së Parkimit miratohet nga Këshilli Bashkiak.

## **KREU II TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

### **Neni 5 Detyrimet dhe Zotimet**


BT dhe Koncesionari, janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të Projektit. Përveç, si edhe duke mos nënkuptuar asnjë shmangie apo zëvendësim të cilitdo nga detyrimet e përcaktuara tjetërkund në këtë Kontratë, Palët bien dakord dhe marrin përsipër si vijon:

#### **5.1 Detyrime të përgjithshme të Konçesionarit**

5.1.1 Veçanërisht Koncesionari duhet që:

- (a) të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, Shoqërinë Konçesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.




- 
- (b) një kopje e aktit të themelimit dhe statutit, të cilin dorëzohet BT-së 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara aplikimit për regjistrim të shoqërisë së re si person juridik, për të marrë miratimin e BT-së. Në rast vonese për shprehjen e miratimit tej afatit 10 (dhjetë) ditë, konsiderohet se BT-ja nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë, kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:
- (i) Forma e shoqërisë: forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionare”, duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
  - (ii) Objekti i shoqërisë: duhet të përmbajë vetëm ndërtimin, operimin dhe transferimin e parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë, tek BT, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, ofrimi dhe shfrytëzimi i shërbimit të parkimit nëntokësor, në zbatim të kësaj Kontrate dhe veprimtari ekonomike funksionalisht të lidhura me to;
  - (iii) Themeluesi i shoqërisë: shoqëria e re do të themelohet nga Konçesionari.
- (c) Konçesionari do të jetë solidarisht përgjegjës me Shoqërinë Konçesionare për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë, në proporcion me kuotat e zotëruara prej tij në këtë shoqëri.

5.1.2 Në vijim, Konçesionari/Shoqëria Konçesionare, me shpenzimet dhe kostot e tij/saj, do të:

- (a) ndërtojë, operojë dhe transferojë Pasuritë e Projektit/Mjedisin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, Praktikën e Mirë Industriale dhe Legjislacionin e Zbatueshëm;
- (b) aplikojë për t’u pajisur me lejet e nevojshme për ndërtimin e Projektit, brenda 6 (gjashtë) muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate;
- (c) marrë të gjitha Lejet e Zbatueshme në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe të jetë në përputhje me to në çdo kohë gjatë Periudhës së Koncesionit Pas marrjes së lejeve të lartpërmendura, Konçesionari duhet të fillojë punimet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor;
- (d) zbatojë preventivin dhe Grafikun e Punimeve të paraqitur sipas Shtojcës 3, bashkëlidhur Kontratës;
- (e) në rast ndryshimesh të Projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), Palët angazhohen të ndryshojnë këtë Kontratë në përputhje me Projektet e ndryshuara. Për këtë qëllim, Palët do të takohen e diskutojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim të Palës tjetër. Palët bien dakord se Konçesionari nuk do të jetë subjekt penaltetesh në kuptim të kësaj Kontrate, nga dita e zbardhjes së vendimit të KKT që ndryshon Projektet e deri në momentin e ndryshimit të kësaj Kontrate, në rast se si rrjedhojë e ndryshimeve në Projekte preken edhe afatet përkatëse për realizimin e tyre;



- 
- (f) marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afatëve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- (g) të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndikim apo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes);
- (h) të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventalisht mund t'i shkaktohen BT-së apo palëve të treta për faj të Konçesionarit, sipas përcaktimeve në këtë Kontratë;
- (i) të mbajë të informuar BT-në për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e Projektit, sipas përcaktimeve në këtë Kontratë;
- (j) Konçesionari është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- (g) sigurojë të gjithë ndihmën e nevojshme për Inxhinierin e Pavarur dhe për Grupin Drejtues, siç ata mund arsyeshmërisht të kërkojnë për përmbushjen e detyrave dhe shërbimeve të tyre sipas kësaj Kontrate;
- (h) sigurojë Grupit Drejtues dhe BT raporte të herëpashershme gjatë Periudhës së Zbatimit dhe Periudhës së Operimeve, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
- (i) zhvillojë, zbatojë dhe administrojë një program mbikëqyrje dhe sigurie për Projektin/Mjedisin e Projektit dhe përdoruesit e tij si dhe për personelin e nënkontraktuesve të përfshirë në kryerjen e shërbimeve sipas kontratave të Projektit, duke përfshirë këtu riparimin e shkeljeve dhe mangësive të sigurisë, si edhe duke ndërmarrë të gjitha masat e tjera të nevojshme për të siguruar një mjedis të sigurtë, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Praktikën;
- (j) sigurojë dhe ruajë, me fuqi dhe efekte të plota, të drejtat e pronësisë, licencat, marrëveshjet dhe lejet për materialet, metodat, proceset dhe sistemet e përdorur apo të trupëzuara në Projekt, nëse do të jetë e nevojshme;
- (k) të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- (l) bëjë përpjekje për të ruajtur harmoninë dhe marrëdhëniet e mira industriale ndërmjet personelit të punësuar në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate;







- (m) bëjë rregullimet e tij për të respektuar e plotësuar kërkesat mjedisore dhe të tjera sipas Ligjeve të Zbatueshme dhe Lejeve të Zbatueshme;
- (n) jetë përgjegjës për sigurinë, saktësinë dhe qëndrueshmërinë e Mjedisit të Projektit, duke përfshirë të gjitha strukturat që janë pjesë e tij dhe përputhshmërinë e tyre me Specifikimet Teknike dhe Standardet;
- (o) operojë dhe mirëmbajë Projektin në çdo kohë gjatë Periudhës së Operimeve në pajtim me këtë Kontratë, duke përfshirë por pa u kufizuar në Specifikimet Teknike dhe Standardet, Programin e Mirëmbajtjes dhe në Praktikën e Mirë Industriale;
- (p) paguajë për BT të gjithë Tarifën Konçesionare të përcaktuar në Nenin 2.3 e kësaj Kontrate;
- (q) Konçesionari duhet t'i dërgojë çdo vit BT një Raport Vjetor të posaçëm, i cili do të përmbajë aspektin kryesor të standardit të cilësisë dhe sasisë të shërbimit të ofruar, për t'u rënë dakord me BT. Veçanërisht:
  - (i) numrin e makinave të parkuara sipas llojit të tarifës, llojit të ditës, javës, muajit, tremujorit dhe vitit;
  - (ii) diagramin e rrjedhës mesatare të hyrjeve dhe daljeve sipas llojit të tarifave për çdo gjysmë ore;
  - (iii) periudha mesatare e zënies;
  - (iv) të ardhurat sipas periudhave të ndryshme kohore, orëve, ditëve, javëve, muajve, tremujorëve dhe viteve; ose
  - (v) çdo të dhënë tjetër të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga BT.
- (r) Konçesionari nuk ka të drejtë të vendos Barrë mbi Vendndodhjen e Projektit, por ka të drejtë të vendosë Barrë mbi Mjedisin e Projektit dhe kuotat e Shoqërisë Konçesionare gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës, si dhe të lidhë Marrëveshje Financuese me çdo Palë Financuese, me kusht që t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate.

## **5.2 Detyrimet e Konçesionarit gjatë Periudhës së Zbatimit**

- 5.2.1 Mbi bazën e të dhënave të Projektit, investimet që duhet të kryhen nga Konçesionari janë në vlerën totale prej 1.937.932.800 (një miliard e nëntëqindetridhjeteshtatë milion e nëntëqindetridhjetedy mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, sipas ofertës së paraqitur në procedurën konkurruese.
- 5.2.2 (a) Konçesionari, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit të Projektit, do të:
  - (i) paraqesë Inxhinierit të Pavarur programin e tij kohor për projektimin, ndërtimin dhe operimin në lidhje me Programin e Përfundimit të Projektit dhe Datën e Programuar të Përfundimit të Projektit;
  - (ii) ketë organizimin e kërkuar, të identifikojë dhe emërojë përfaqësues të përshtatshëm, siç ai mund të vlerësojë të arsyeshme, për të ndjekur zbatimin e



Projektit dhe për të komunikuar me Inxhinierin e Pavarur, Grupin Drejtues dhe BT. Përfaqësuesi do të jetë përgjegjës për të gjithë shkëmbimin e nevojshëm të informacionit të kërkuar, në pajtim me këtë Kontratë;

(iii) marrë përsipër dhe kryejë të gjithë veprimet e punët e nevojshme që kërkohen, për të mundësuar Programin e Përfundimit të Projektit dhe për të arritur përfundimin e Projektit sipas dhe në përputhje me këtë Kontratë.

(b) Konçesionari, në çdo kohë do t'i mundësojë hyrjen në Vendndodhjen e Projektit Grupit Drejtues, përfaqësuesve të autorizuar të BT, Inxhinierit të Pavarur dhe çdo zyrtari të cilit do institucioni publik që ka juridiksion mbi Projektin, duke përfshirë ato që merren me sigurinë, sigurimin, apo mbrojtjen e mjedisit që të kontrollojnë Projektin dhe të kërkojnë mbi çdo çështje brenda autoritetit të tyre, duke marrë prej tyre një njoftim paraprak.

(c) Konçesionari do të:

(i) kërkojë dhe marrë të gjitha lejet dhe/ose miratimet e nevojshme për ndërtimin e Mjedisit të Projektit; dhe

(ii) bëjë, nëse ka, pagesa për (1) miratimin e Projekteve, (2) kuadrin e sigurisë, (3) mbikëqyrjen e ndërtimit dhe (4) mirëmbajtjen gjatë Periudhës së Koncesionit.

5.2.3 Konçesionari merr përsipër të verë në punë Mjedisin e Projektit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga Data e Fillimit, sipas Programit të Përfundimit të Projektit të paraqitur në Shtojcën 3, bashkëlidhur.

### 5.3 Nënkontraktimi

5.3.1 Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar dispozitat e parashikuara në Nenin 5.1.2. Në të gjithë kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate.

5.3.2 Konçesionari duhet të pajisë BT-në me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktuesin e propozuar:

(a) emrin e tij dhe adresën;

(b) qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar;

(c) vlerën e nënkontratës.

5.3.3 Konçesionari është përgjegjës përpara BT-së individualisht dhe solidarisht me nënkontraktuesin, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

5.3.4 BT-ja nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.



#### 5.4 Detyrimet e BT-së

BT do të:

- 5.4.1 Dorëzojë zotërimin/posedimin fizik të Vendndodhjes së Projektit tek Koncesionari, të lirë nga çdo lloj Barre, pas anjë defekt dhe të metë, sipas përcaktimit të bërë në 2.8 brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Në datën e dorëzimit të Vendndodhjes së Projektit tek Koncesionari, Palët do të nënshkruajnë një vërtetim pranimi të dorëzimit, sipas Shtojcës 5 të kësaj Kontrate;
- 5.4.2 Sigurojë përdorimin e qetë të Vendndodhjes së Projektit nga Koncesionari sipas dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate pa asnjë pengim apo pengesë nga BT ose nga persona që paraqesin pretendime, përmes apo sipas saj, duke marrë vetë përsipër çdo procedurë dhe kosto të lidhur me to në lidhje me shpronësime të mundshme, pretendime të të tretëve, etj.
- 5.4.3 Sigurojë bashkëpunimin dhe ndihmën e nevojshme për Koncesionarin, për përfitim në kohën e duhur të Lejeve të Zbatueshme dhe në bazë të kërkesave të Koncesionarit, do t'i japë Koncesionarit brenda një periudhe të arsyeshme të gjitha dhe çdo dokument dhe informacion në mënyrë që Koncesionari të përfitojë Lejet e Zbatueshme dhe në veçanti lejen e zhvillimit/ndërtimit;
- 5.4.4 Ndhimojë Koncesionarin, në bazë të kërkesës së tij me shkrim, që të ketë akses në të gjitha lehtësirat dhe shërbimet e infrastrukturës duke përfshirë ujën, energjinë elektrike dhe shërbimet e telekomunikacionit në nivele dhe kushte jo më pak të favorshme për Koncesionarin, se sa ato që janë përgjithësisht të mundshme për blerësit me qëllime tregtare që përfitojnë lehtësira/shërbime të ngjashme;
- 5.4.5 Sigurojë bashkëpunimin dhe ndihmën e nevojshme për Koncesionarin për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit me Palët Financuese, me anë të vënies në dispozicion të gjithë dokumentacionin, informacionin në lidhje me Projektin dhe çdo instrumenti tjetër në posedim BT, si dhe të ndërmarrë çdo veprim të ligjshëm që nënshkruajnë do të sjell finalizimin e Marrëveshjes Financiare.
- 5.4.6 Inspektojë dhe mbikëqyrë në çdo kohë, me përfaqësuesit e saj të autorizuar të gjitha punimet në vijimësi zbatimi apo që janë zbatuar në përputhje me dispozitat e Kreut III të kësaj Kontrate.
- 5.4.7 Vëzhgojë dhe veprojë në përputhje me të gjitha përcaktimet e parashikuara në këtë Kontratë.





## Neni 6 Deklarimet dhe Garancitë, Përjashtimi i Përgjegjësive

### 6.1 Deklarimet dhe Garancitë e Konçesionarit

Konçesionari deklaron dhe garanton BT-në se:

- 6.1.1 Ekziston në mënyrë të vlefshme, është i organizuar në mënyrën e duhur dhe nuk është subjekt procedurash likuidimi ose falimentimi sipas legjislacionit shqiptar;
- 6.1.2 Ka tagrat dhe autoritetin e plotë që të zbatojë, dorëzojë dhe përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate;
- 6.1.3 Ka marrë ose do të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme për shoqërinë, ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë të tjera veprime sipas ligjeve të zbatueshme dhe në përputhje me aktet e tij të themelimit për të autorizuar zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate;
- 6.1.4 Gëzon kapacitetet teknike dhe financiare për realizimin e Projektit;
- 6.1.5 I nënshtrohet ligjeve civile dhe tregtare të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me këtë Kontratë dhe që heq dorë në mënyrë të shprehur dhe të parevokueshme nga çdo imunitet në çdo juridiksion në lidhje me të;
- 6.1.6 Zbatimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk është në kundërshtim me kontrata të tjera në të cilat ai është palë, apo nga të cilat ai ose cilado prej pasurive të tij, preken apo kufizohen;
- 6.1.7 Për aq sa Konçesionarit ka dijeni, nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka kallëzime ose ndjekje penale që mund të prekin Konçesionarin ose kapitalin e tij, përpara cilëdo gjykatë ose përpara cilitdo autoritet tjetër gjyqësor apo autoriteti tjetër, rezultat i të cilit mund të sjellë pasoja në shkeljen apo në shkaktimin e një mospërmbushje të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate, ose që individualisht apo në tërësi mund të çojë në çfarëdo Pasojë Materiale të Padëshiruar;
- 6.1.8 Nuk është në dijeni të shkeljeve apo mospërmbushjeve në lidhje me çfarëdo urdhri, vendimi apo akti të çfarëdo gjykate apo të çfarëdo urdhri ligjërishit e detyruar të një autoriteti shtetëror, që mund të çojë në çfarëdo Pasojë Materiale të Padëshiruar apo në cënim të aftësisë së Konçesionarit, për të përmbushur detyrimet dhe detyrat e tij sipas kësaj Kontrate;
- 6.1.9 Ka vepruar dhe do të veprojë në përputhje me të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm dhe nuk i është nënshtuar asnjë gjobe, dënimi, vendimi të ndërmjetëm ose çfarëdo

përgjegjësie tjetër civile ose penale, e cila në tërësi ka apo mund të ketë një Pasoja Materiale të Padëshiruara;



- 6.1.10 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë Koncesionare tek të tretë Koncesionari do të marrë miratimin me shkrim të BT-së. Në këtë rast, palës së tretë do t'i transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në këtë Kontratë, përveç kur ky transferim vjen si pasojë e zbatimit të Marrëveshjeve të Financimit në përputhje me hapat e parashikuar në Nenin 14;
- 6.1.11 Në çdo rast, të gjitha të drejtat dhe interesat e Koncesionarit në dhe ndaj Pasurive të Projektit/Mjedisit të Projektit, do t'i kalojnë BT-së në datën e mbarimit të Periudhës së Koncesionit apo zgjidhjes së Kontratës, të lira nga çdo Barrë dhe pa pasur nevojë për akte apo vendime të mëtejshme nga Koncesionari ose BT;
- 6.1.12 Asnjë shumë, në para apo në natyrë, nuk është paguar ose do të paguhet nga apo në emër të Koncesionarit ndaj cilitdo person përmes tarifave, përqindjeve, apo mënyrave të tjera për të siguruar Koncesionin, ose për të lidhur këtë kontratë, ose për të ndikuar apo për t'u përpjekur për të ndikuar cilindo zyrtar apo punonjës të BT, në lidhje me të;
- 6.1.13 Çdo deklaratë apo garanci e Koncesionarit që përmbahet në këtë Kontratë apo në cilindo dokument tjetër që i ka paraqitur BT-së, ose cilindo institucioni publik në lidhje me Lejet e Zbatueshme, nuk përmban apo do të përmbajë deklaram/e të pavërteta të fakteve materiale ose një fakt material që e bën këtë deklaram apo garanci të rreme;
- 6.1.14 Kjo Kontratë përbën për Koncesionarin detyrimin ligjor, të vlefshëm dhe kushtëzues, të zbatueshëm ndaj tij në përputhje me kushtet e parashikuara në të.


## **6.2 Përjashtimi i Përgjegjësie**

- 6.2.1 Pa çenuar dispozitat e parashikuara shprehimisht në këtë Kontratë, Koncesionari, pas një shqyrtimi të plotë dhe të kujdesshëm, ka bërë një vlerësim të pavarur të vëllimeve të trafikut, Specifikimeve Teknike dhe Standardeve, Vendndodhjes së Projektit dhe të të gjithë informacionit të siguruar nga BT. Duke u mbështetur në këtë vlerësim Koncesionari ka përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e këtyre vështirësive, rreziqeve dhe problemeve, siç ato mund të dalin apo ndeshen nga Koncesionari, në rrjedhën e përmbushjes së detyrimeve të tij të këtushme.
- 6.2.2 Koncesionari njeh më tej dhe pranon rrezikun e papërshtatshmërisë, gabimit apo lajthitjes, në apo në lidhje me cilëndo nga çështjet e parashikuara në Nenin 6.2.1 më lart dhe pohon këtu, se BT nuk do të jetë përgjegjëse për Koncesionarin dhe çështjet e lidhura me të.

## **6.3 Deklarimet dhe garancitë e BT**

BT deklaron dhe garanton Koncesionarin se:



- 
- 6.3.1 BT gëzon tagra dhe autoritet të plotë që të japë Koncesionin;
- 6.3.2 BT ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate;
- 6.3.3 Dhënia e Koncesionit në tërësi është një procedurë e rregullt ligjore, konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe se lidhja e kësaj Kontrate mes palëve është e rregullt ligjore dhe e pakontestueshme nga të tretë;
- 6.3.4 Kjo Kontratë përbën për BT detyrim ligjor dhe të vlefshëm të zbatueshëm ndaj saj në përputhje me kushtet e parashikuara në të.

### **KREU III STRUKTURA TË TJERA**

#### **Neni 7 Inxhinieri i Pavarur**

##### **7.1 Caktimi i Inxhinierit të Pavarur**

- 7.1.1 Koncesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, me qëllim caktimin e Inxhinierit të Pavarur, do t'i paraqesë BT të paktën tre subjekte me reputacion profesional, që kanë ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë, ekzekutuar dhe përmbushur detyrat, përgjegjësitë, shërbimet dhe veprimtaritë e parashikuara në Shtojcën 6 të kësaj Kontrate.
- 7.1.2 BT, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit ose (i) do t'i kërkojë Koncesionarit që të propozojë një ose disa subjekte të tjerë ose (ii) do të caktojë Inxhinierin e Pavarur nga paneli i propozuar dhe do t'ia komunikojë këtë Koncesionarit. E njëjta procedurë do të zbatohet edhe në rast se kontrata me Inxhinierin e Pavarur zgjidhet. Detyrat specifike të Inxhinierit të Pavarur do të përcaktohen në përputhje me Shtojcën 6 të kësaj Kontrate dhe në kontratën e lidhur me të.
- 7.1.3 Inxhinieri i Pavarur do t'i paraqesë raporte Grupit Drejtues dhe BT-së, të paktën një herë në muaj ose më shpesh, siç mund të kërkohet nga ecuria e punimeve gjatë zbatimit të projektit. Këto raporte të Inxhinierit të Pavarur përfshijnë, por nuk kufizohen, në veprimtarinë dhe detyrat e parashikuara në Shtojcën 6 të kësaj Kontrate.
- 7.1.5 Nëse njëra nga Palët kundërshton një nga këshillat, udhëzimet apo vendimet e Inxhinierit të Pavarur, kjo do të zgjidhet nëpërmjet procedurës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.
- 7.1.6 Inxhinieri i Pavarur, me qëllim për të vlerësuar nivelin e shërbimit ndaj klientit, do të kryerje vëzhgime gjatë gjithë Periudhës së Operimeve.



7.1.7 Kostot e Inxhinierit të Pavarur do të përballohen nga Konçesionari ose Shoqëria Konçesionare dhe do të përlogariten në shpenzime të njohura për Shoqërinë Konçesionare.

## **Neni 8 Grupi Drejtues**

### **8.1 Krijimi**

BT, përmes një urdhëri të titullarit, do të krijojë një Grup Drejtues me përfaqësues nga BT, Konçesionari apo Pala Financuese, nëse e interesuar, brenda 3 (tre) muajve nga data e nënshkrimit të Kontratës.

### **8.2 Funkcionet**

Grupi Drejtues do të mbajë takime të paktën një herë në 3 (tre) muaj, për të analizuar ecurinë dhe përparimin gjatë Periudhës së Zbatimit dhe çdo 6 (gjashtë) muaj, për të analizuar ecurinë dhe efikasitetin gjatë Periudhës së Operimit. Grupi Drejtues do të ushtrojë funksionet dhe kompetencat sipas parashikimeve të kësaj Kontratë.

## **KREU IV PROJEKTI**

### **Neni 9 Përgatitja dhe Rishikimi i Projekteve**

#### **9.1 Përgatitja e Projekteve**

Konçesionari, me kostot dhe shpenzimet e Shoqërisë Konçesionare, do të mundësojë hartimin e Projekteve në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet.

#### **9.2 Shqyrtimi dhe miratimi i Projekteve**

9.2.1 Në përputhje me Programin e Përfundimit të Projektit Konçesionari paraqet menjëherë një kopje të Projekteve për Inxhinierin e Pavarur, Grupin Drejtues dhe për BT.

9.2.2 Me përcjelljen e Projekteve sipas Nenit 9.2.1 më lart, Konçesionari ka verifikuar dhe vlerëson se Projekti është në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet.

9.2.3 Inxhinieri i Pavarur do të rishikojë Projektet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së tyre, duke marrë parasysh, ndër të tjera, observacionet e Grupit Drejtues apo BT-së, nëse ka. Inxhinierit të Pavarur do t'i përcjellë Konçesionarit observacionet e tij, nëse ka, duke iu referuar veçanërisht përputhshmërisë ose jo me Specifikimet Teknike dhe Standardet. Pavarësisht rishikimit dhe observacioneve të Inxhinierit të Pavarur/Grupit Drejtues apo mungesës së tyre, BT nuk do të jetë përgjegjëse për përshtatshmërinë e



Projekteve. Si rrjedhim, Konçesionari do të mbetet përgjegjës, nuk do të çlirohet nga detyrimet apo shkarkohet nga përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Kontratë.

- 9.2.4 Nëse konstatimet e Inxhinierit të Pavarur tregojnë se, Projektet nuk janë në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet, këto Projekte do të rishikohen nga Konçesionari në masën që është e nevojshme dhe do t'i paraqiten sërish Inxhinierit të Pavarur për rishikim të mëtejshëm, brenda afatit të përcaktuar nga Inxhinieri i Pavarur për këtë qëllim. Inxhinieri i Pavarur do të japë observacionet e tij, nëse ka, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e këtyre Projekteve të rishikuara. Pavarësisht rishikimit dhe observacioneve të Inxhinierit të Pavarur apo mungesës së tyre, Konçesionari do të mbetet përgjegjës dhe nuk do të çlirohet nga detyrimi për të qenë në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet.
- 9.2.5 Nëse Inxhinieri i Pavarur nuk do të ketë kundërshtime për Projektet e paraqitura nga Konçesionari, sipas Nenit 9.2.3 ose Nenit 9.2.4 mësipër, Konçesionari do të ketë të drejtë të procedojë me Projektin.
- 9.2.6 Konçesionari do të jetë përgjegjës për vonesat në Përfundimin e Projektit dhe pasojat përkatëse për shkak të mospërputhjes së Projekteve me Specifikimet Teknike dhe Standardet. Konçesionari nuk do të ketë të drejtë të kërkojë lehtësim në lidhje me këtë nga BT, përveç kur këto vonesa janë shkaktuar në mënyrë të paarsyeshme nga Inxhinieri i Pavarur.

## **Neni 10** **Zbatimi dhe Operimet e Projektit**

### **10.1 Vëzhgimi dhe mbikëqyrja gjatë zbatimit**

- 10.1.1 Gjatë Periudhës së Zbatimit, Konçesionari do t'i sigurojë Grupit Drejtues dhe BT raporte tremujore mbi përparimin e bërë në punimet e ndërtimit të Projektit si edhe çdo informacion tjetër me rëndësi, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Grupi Drejtues dhe BT.
- 10.1.2 Konçesionari do të kryejë prova/teste në kohën, shpeshësinë dhe mënyrën e përcaktuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm, në përputhje me Praktikën e Mirë Industriale ose siç mund të jetë e nevojshme, për të siguruar se ndërtimi i Projektit po ndërmerret në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet, Praktikën e Mirë Industriale, si edhe për të siguruar cilësinë e tij. Konçesionari do të marrë menjëherë masa për të rregulluar defektet dhe mangësitë eventuale, që rezultojnë gjatë këtyre Provave/Testeve. Konçesionari, brenda 7 (shtatë) ditëve, do t'i përcjellë Inxhinierit të Pavarur, Grupit Drejtues dhe BT rezultatet e këtyre provave/testeve dhe do t'i raportojë menjëherë masat e marra për të rregulluar defektet dhe mangësitë që do të rezultojnë gjatë këtyre Provave/Testeve.







- 10.1.3 Nëse Inxhinieri i Pavarur në mënyrë të arsyeshme konstaton se niveli i përparimit në ndërtim bën të pamundur Përfundimin e Projektit në/ apo përpara Datës së Programuar për Përfundimin e Projektit dhe ky fakt nuk është raportuar nga Konçesionari sipas përcaktimeve të bëra në nenin 5.1.2 (h), ai do të njoftojë për këtë Konçesionarin, BT-në dhe Grupin Drejtues. Pas kësaj, Konçesionari njofton brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve BT-në, Grupin Drejtues dhe Inxhinierin e Pavarur, për hapat që do të ndërmarrë për të përshpejtuar ndërtimin dhe periudhën brenda të cilës ai do të realizojë DOT-in.
- 10.1.4 Nëse BT udhëzon pezullimin e Punimeve të Ndërtimit për çfarëdolloj arsye, të ndryshme nga pakujdesia apo shkëlja e kësaj Kontrate nga Konçesionari, Programi i Përfundimit të Projektit dhe Data e Programuar e Përfundimit të Projektit do të zgjaten për aq sa të jetë periudha e pezullimit.

## 10.2 Provat dhe Testimet

- 10.2.1 Të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të mundshëm të Projektit, Konçesionari do të njoftojë Inxhinierin e Pavarur, BT-në dhe Grupin Drejtues për këtë përfundim dhe për realizimin e Provave/Testimeve. Konçesionari do t'i japë Inxhinierit të Pavarur, BT-së dhe Grupit Drejtues, një njoftim të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës në të cilën ai ka për qëllim të fillojë Provat/Testimet dhe të paktën 7 (shtatë) ditë, përpara njoftimit të fillimit të cilësdo Provë/Testim vijues.
- 10.2.2 Të gjitha Provat/Testimet do të kryhen në përputhje me Shtojcën 4 dhe Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Lejet e Zbatueshme. BT do të ketë të drejtën të pezullojë apo shtyjë cilëndo Provë/Test nëse gjatë kryerjes së saj rezulton se përmbushja e Projektit ose cilësdo pjese të tij nuk është në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet. BT mund të caktojë një përfaqësues me kualifikimet dhe përvojën e duhur për të mbikëqyrur Provat//Testet.
- 10.2.3 Inxhinieri i Pavarur do të vëzhgojë Provat/Testet dhe do të përcaktojë përputhshmërinë e Projektit me Specifikimet Teknike dhe Standardet duke i përcjellë Grupit Drejtues dhe BT-së, kopje të të gjitha të dhënave të Provave/Testeve, përfshirë këtu rezultatet e hollësishme të tyre.
- 10.2.4 Pasi të jetë vërtetuar se Provat/Testet kanë qenë të suksesshme dhe janë respektuar të gjitha dispozitat ligjore të përcaktuara për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për pajisjen me leje shfrytëzimi, regjistrimin e objektit në ZRPP dhe të gjitha dispozitat e tjera të lidhura me këtë koncesion, Inxhinieri i Pavarur do të lëshojë për Konçesionarin certifikatën e përmbushjes në formën e përcaktuar në Shtojcën 6 ("Çertifikata e Përmbushjes") të kësaj Kontrate.
- 10.2.5 Nëse Provat/Testet nuk mund të kryhen ose duhen pezulluar, Konçesionari do t'i riprogramojë Provat/Testet dhe do t'i kryejë ato sa më shpejt që të jetë e mundur.





10.2.6 Konçesionari ose Shoqëria Koncesionare do të përballojë të gjitha shpenzimet në lidhje me Provat/Testet e kësaj Kontrate.

### 10.3 Përfundimi i Projektit

10.3.1 Projekti do të vlerësohet i plotë dhe gati për përdorim, vetëm kur të lëshohet “Çertifikata e Përmbyshjes” nga Inxhinieri i Pavarur, në përputhje me Shtojcën 6 të kësaj Kontrate.

10.3.2 Konçesionari garanton se DOT do të arrihet në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate në një datë jo më të vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) muaj nga Data e Fillimit, përveç rasteve të shtyrjeve të miratuara nga BT (“Data e Programuar të Përfundimit të Projektit”).

10.3.3 Nëse, për cilindo shkak qoftë, Projekti nuk përfundon në Datën e Programuar të Përfundimit të Projektit, përcaktuar në Nenin 10.3.2 mësipër, Konçesionari do të jetë përgjegjës për vonesën përtej kësaj date, duke përjashtuar këtu Forcën Madhore apo shkaqe që i atribuohen BT-së dhe institucioneve publike të tjera sipas Nenit 2.5.2 (d). BT do të njoftojë menjëherë me shkrim Konçesionarin për vonesën e konstatuar në Programin e Përfundimit të Punimeve duke i caktuar këtij të fundit një afat prej të paktën 30 (tridhjetë) ditësh për eliminimin e mospërmbyshjes dhe të pasojave të saj (nënkupton “**Periudhën e Faljes**”). Nëse, mospërmbyshjet dhe pasojat nuk janë eliminuar pas përfundimit të Periudhës së Faljes, Konçesionari do ti paguajë BT një penaltet prej:

(i) 10.000 (dhjetë mijë) Lekë në ditë për muajin e parë që fillon nga data e nesërme e përfundimit të Periudhës së Faljes; dhe

(ii) 20.000 (njëzet mijë) Lekë në ditë për muajin e dytë e në vijim deri në përfundim të afatit prej 6 (gjashtë) muajve që fillon nga data e nesërme e përfundimit të Periudhës së Faljes.


10.3.4 Nëse DOT nuk arrihet brenda 6 (gjashtë) muajve nga Data e Programuar e Përfundimit të Projektit, duke përfshirë këtu Periudhën e Faljes sipas Nenit 10.3.3 mësipër, BT do të ketë të drejtën të zgjidhë Kontratën në përputhje me Nenin 12.1.1 dhe Nenin 12.2.2 vijues.

### 10.4 Operimi dhe Mirëmbajtja

10.4.1 Koncesionari do të operojë dhe mirëmbajë Projektin/Mjedisin e Projektit vetë apo përmes një nënkontraktori dhe nëse kërkohet, do të ndryshojë, riparojë ose përmirësojë në Projektin/Mjedisin e Projektit, për të qenë në përputhje me Specifikimet Teknike dhe Standardet, si edhe me kërkesa të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, në Praktikën e Mirë Industriale, në Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Lejet e Zbatueshme. Më specifikisht, Koncesionari do të jetë përgjegjës për:

(i) përlllogaritjen dhe mbledhjen e Tarifës së Parkimit në përputhje me Shtojcën 1;





(iii) mirëmbajtjen e zakonshme dhe jashtëzakonshme, duke përfshirë këtu riparime të menjëhershme, në respektim të normave vjetore të amortizimit sipas përcaktimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm;

(iii) punimet e mirëmbajtjes, në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes dhe me Programin e Mirëmbajtjes;

(iv) Respektimin e Kërkesat Minimale të Operimit dhe Mirëmbajtjes, të përcaktuara në Shtojcën 7.

## 10.5 Manuali i Mirëmbajtjes

10.5.1 Konçesionari, jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë përpara DOT, do të përgatisë manualin për mirëmbajtjen e Projektit dhe marrjen e masave parandaluese në konsultim me Mbikëqyrësin e Operimit dhe Grupin Drejtues ("**Manuali i Mirëmbajtjes**").

10.5.2 Konçesionari do të sigurojë dhe garantojë mirëmbajtjen e Projektit në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes, Specifikimet Teknike dhe Standardet, gjatë gjithë Periudhës së Operimeve.

10.5.3 Të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara DOT, Konçesionari do të sigurojë 10 (dhjetë) kopje të Manualit të Mirëmbajtjes për Inxhinierin e Pavarur dhe BT-në, respektivisht 3 (tre) dhe 7 (shtatë) kopje për secilin.

## 10.6 Programi i Mirëmbajtjes

10.6.1 Jo më vonë se sa 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të Vit Financiar, Konçesionari do t'i paraqesë BT-së dhe Inxhinierit të Pavarur programin e masave parandaluese dhe çdo plan tjetër mirëmbajtjeje të Projektit, të cilët do të hartohen në përputhje me Kërkesat Minimale të Operimit dhe Mirëmbajtjes të parashikuara në Shtojcën 7, të nevojshëm për të mirëmbajtur Projektin sipas Specifikimet Teknike dhe Standardeteve ("**Programi i Mirëmbajtjes**"). Programi i Mirëmbajtjes do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në, sa vijon:

- (a) intervalet dhe procedurat për kryerjen e inspektimeve në të gjithë elementët e Projektit;
- (b) kriteret që duhen miratuar për të vendosur mbi nevojat e mirëmbajtjes;
- (c) plani mbrojtës i mirëmbajtjes;
- (d) intervalet në të cilat Konçesionari do të kryejë mirëmbajtjen e herëpashershme; dhe
- (e) intervalet për ndërhyrjet më të mëdha të mirëmbajtjes dhe qëllimi i tyre.

10.6.2 Mirëmbajtja do të përfshijë zëvendësimin e pajisjeve, sendeve të konsumueshme, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve, dyshemeve, strukturave dhe punime të tjera civile



të cilat janë pjesë e Projektit/Mjedisit të Projektit, në respektim të normave vjetore të amortizimit sipas përcaktimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm

10.6.3 Konçesionari do të mbajë Mjedisin e Projektit në kushte të pastra dhe të rregullta.

#### 10.7 Vëzhgimi dhe mbikëqyrja gjatë operimit

10.7.1 Konçesionari do të kryejë inspektime të herëpashershme të Projektit, në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes, Programin e Mirëmbajtjes, Specifikimet Teknike dhe Standardet dhe me këtë Kontratë, si dhe do të paraqesë raporte të këtyre inspektimeve ("**Raportet e Mirëmbajtjes**") për BT-në, Grupit Drejtues dhe Inxhinieri i Pavarur.

10.7.2 Inxhinieri i Pavarur do të ndërmarrë inspektime të herëpashershme të Projektit (të paktën një herë në tre muaj), për të verifikuar kushtet e Projektit duke përfshirë këtu përputhshmërinë e tij ose jo me Manualin e Mirëmbajtjes, Programin e Mirëmbajtjes, Specifikimet Teknike dhe Standardet dhe me këtë Kontratë e do të bëjë një raport të këtij inspektimi ("**Raporti i Inspektimit të Operimit dhe Mirëmbajtjes**") dhe do t'ia përcjellë këtë raport Konçesionarit dhe një kopje Grupit Drejtues dhe BT. Në Raportin e Inspektimit të Operimit dhe Mirëmbajtjes do të pasqyrohen defektet dhe mangësitë nëse ka dhe mund gjithashtu të kërkohet që Konçesionari, të ndërmarrë prova të tilla që nevojiten për qëllimin e përcaktimit se Projekti është në çdo kohë në pajtim me Specifikimet Teknike dhe Standardet.

10.7.3 Konçesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e Raportit të Inspektimit të Operimit dhe Mirëmbajtjes nga Inxhinieri i Pavarur, do riparojë defektet dhe mangësitë dhe të kryejë teste, nëse kërkohen, pa asnjë vonesë dhe do të paraqesë evidenca të përputhshmërisë dhe/ose rezultateve përkatëse tek Inxhinieri i Pavarur së bashku me një raport ("**Raporti i Përputhshmërisë me Inspektimin**"), me një kopje drejtuar Grupit Drejtues dhe BT-së, duke përcaktuar me hollësi (për sa mund të jetë e arsyeshme), masat që janë marrë (nëse janë marrë) për të rregulluar defektet ose mangësitë e treguara në këto rezultate.

10.7.4 Atje ku rregullimi i këtyre defekteve apo mangësive dhe/ose ndërmarrja e këtyre provave do të dojë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë në përputhje me Praktikën e Mirë Industriale, Konçesionari, pasi të njoftojë me shkrim arsyet e shtyrjes, do të ndërmarrë veprimet në përputhje me këtë praktikë dhe do të paraqesë raporte mbi përparimin e tyre çdo 2 (dy) javë dhe si përfundim, Raportin e Përputhshmërisë me Inspektimit.

## KREU V FORCA MADHORE

### Neni 11 Force Majeure (Forca Madhore)



## 11.1 Ngjarja e Forcës Madhore (Force Majeure)

Në këtë Kontratë, një ngjarje e Forcës Madhore do të nënkuptojë zhvillimin në Shqipëri të njëjës apo të gjitha ngjarjeve të përcaktuara në Nenet 11.2, 11.3 dhe 11.4, të cilat pengojnë Palën që pretendon se ka pasur Forcë Madhore ("**Palën e Prekur**") nga përmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate dhe kjo ngjarje apo veprim:

- (i) është përtej kontrollit të arsyeshëm dhe nuk vjen për shkak të fajit të Palës së Prekur;
- (ii) Pala e Prekur nuk ka qenë në gjendje ta zgjidhë këtë veprim apo ngjarje, duke ushtruar analizën, përpjekjet e arsyeshme, aftësinë dhe kujdesin e duhur; dhe
- (iii) ka një Pasojë Materiale të Padëshiruar mbi Projektin.

## 11.2 Përcaktimi i ngjarjeve të Forcës Madhore

11.2.1 Për qëllimet e Nenit 11.1 më lart, ngjarja e Forcës Madhore do të nënkuptojë një ose disa nga veprimet apo ngjarjet në vijim:

- (i) Fatkeqësi natyrore apo ndodhi përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të pritëshin që të ndodhnin, kushte jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufe, tërmete, ciklone, përmbytje, shpërthime vullkanike apo zjarre ose rrëshqitje toke (në masën që ato e kanë prejardhjen nga një burim i jashtëm nga Vendndodhja e Projektit ose përtej përcaktimeve të projekteve për Punimet e Ndërtimit);
- (ii) Kontaminim radioaktiv ose rrezatim jonizues, apo kontaminim kimik ose biologjik;
- (iii) Greva ose bojkotime (të ndryshme nga ato që përfshijnë Konçesionarin, nënkontraktorët ose punonjësit/përfaqësuesit e tyre përkatës, ose që mund t'i atribuohen cilitdo veprim apo mosveprim nga cilitdo prej tyre) që ndërpresin furnizimet dhe shërbimet ndaj Projektit për një periudhë që kalon 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në një Vit Financiar;
- (iv) Një akt lufte (qoftë i shpallur apo i pashpallur), pushtim, konflikt i armatosur apo akt të armikut të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, të cilat e pengojnë mbledhjen e Tarifës nga Konçesionari për një periudhë që tejkalon një periudhë të vazhduar prej 30 (tridhjetë) ditësh në një Vit Financiar;
- (v) Mos-zbatimin e një akti ligjor nga organet kompetente dhe/ose mos-zbatimin për shkaqe jashtë kontrollit të Palës së Prekur, të legjisllacionit në fuqi, moratoriume, pezullime dhe/ose mosmiratime të akteve, të caktuara, të cilat afektojnë ecurinë e



Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve në këtë Kontratë nga ana e Konçesionarit;

(vi) Ndryshime në Legjislacionin e Zbatueshëm të tilla që afektojnë ecurinë e Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Konçesionarit, vetëm kur nuk mund të zbatohen parashikimet e Nenit 19;

(vii) Shpronësimi apo blerja e detyrueshme nga cilado agjensi shtetërore e cilëso pasuri/aset të Projektit ose të të drejtave të Konçesionarit apo të drejtave të kontraktorëve të Konçesionarit;

(viii) Çfarëdo revokimi të paligjshëm apo të paautorizuar apo jashtë juridiksionit nga cilido autoritet shtetëror, ose refuzimi për të rinovuar apo për të dhënë pa një arsye të vlefshme, cilindo pëlqim apo miratim të kërkuar nga Konçesionari apo cilido prej kontraktorëve të tij për të përmbushur detyrimet përkatëse sipas Projektit (të ndryshme nga një pëlqim përfitimi i të cilit është kusht paraprak, si dhe të ndryshme nga pëlqime që varen nga BT), me kusht që kjo vonesë, ndryshim, mohim, refuzim ose revokim të mos ketë ardhur nga paaftësia e Konçesionarit apo e cilitdo prej kontraktorëve të tij për të vepruar në përputhje me cilindo prej kushteve për dhënien, mirëmbajtjen apo rinovimin e këtyrë pëlqimeve.

(ix) Çdo ngjarje apo rrethanë tjetër të një natyre me sa më sipër.

### 11.3 Pasoja e ngjarjes së Forcës Madhore

Pas ndodhjes së çfarëdo ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohet sa vijon:

11.3.1 Nuk do të ketë Zgjidhje të kësaj Kontrate, përveçse siç parashikohet në Nenin 11.5 në vijim;

11.3.2 Kur ngjarja e Forcës Madhore ndodh përpara DOT, Datat e Programuara për Përfundimin e Projektit dhe Periudha së Koncesionit, do të zgjaten po aq sa periudha për të cilën do të vazhdojë Ngjarja e Forcës Madhore;

11.3.3 Kur ngjarja e Forcës Madhore ndodh pas DOT, Konçesionari do të vazhdojë të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të operuar Projektin dhe/ose për të mbledhur Tarifën, por nëse ai është i paaftë apo nuk lejohet që ta bëjë këtë, Periudha e Konçesionit, do të zgjatet sa periudha në të cilën mbledhja e Tarifës mbetet e penguar për shkaqet e mësipërme.

11.3.4 Pavarësisht nga sa më sipër, Pala e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore ka detyrimin të marrë të gjitha masat të cilat mund të merren në mënyrë të arsyeshme për të lehtësuar, kufizuar apo parandaluar përshkallëzimin e pasojave të Ngjarjes së Forcës Madhore, të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme, që të ulë apo kufizojë dëmet ndaj Palës tjetër, që

vijnë nga apo si rrjedhojë e ekzistencës apo ndodhjes së kësaj ngjarje të Forcës Madhore, si dhe të bëjë gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta rregulluar atë me kujdesin e duhur.

#### **11.4 Shpërndarja e kostove gjatë vazhimit të një Ngjarje të Forcës Madhore**

Në të gjithë ngjarjen e Forcës Madhore, Palët do të përballojnë kostot e tyre përkatëse dhe asnjërës Palë nuk do t'i kërkohej që t'i paguajë Palës tjetër çfarëdo kostosh që rrjedhin nga çfarëdo ngjarje e tillë e Forcës Madhore.

#### **11.5 Zgjidhja**

Nëse një ngjarje e Forcës Madhore vazhdon apo, sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve ka të ngjarë të vazhdojë përtej një periudhe prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë Kontratë ose ta vazhdojnë zbatimin e kësaj Kontrate, mbi bazën e kushteve të reja të rena dakord reciprokisht. Nëse Palët nuk janë në gjendje që të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Palët, pas kalimit të periudhës së përmendur prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh, do të kenë të drejtën ta zgjidhin këtë Kontratë duke lëshuar një Njoftim Zgjidhje.

#### **11.6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve në lidhje me Forcën Madhore**

Në rastin kur Palët nuk janë në gjendje të bien dakord me mirëbesim në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e një ngjarje të Forcës Madhore, kjo mosmarrëveshje do të zgjidhet përfundimisht në përputhje me Procedurën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, me kusht që, në çdo rast barra e provës në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e kësaj Ngjarje të Forcës Madhore, të jetë mbi Palën që pretendon lehtësim dhe/ose çlirimin nga mospërbushja, për shkak të kësaj Ngjarje të Forcës Madhore.

#### **11.7 Përgjegjësia për humbje të tjera, dëmtime, etj**

11.7.1 Përveçse siç parashikohet shprehimisht në Nenin 11, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë lloj mënyre ndaj Palës tjetër në lidhje me çfarëdo humbjes, dëmtimesh, kostosh, shpenzimesh, pretendimesh, kërkesash dhe procedimesh, në lidhje me/apo që rrjedhin nga ndodhja apo ekzistenca e çfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, ose ushtrim të çfarëdo të drejte në përputhje me Nenin 11.

#### **11.8 Detyrimi për të raportuar**

Pala e Prekur do t'i raportojë Palës tjetër mbi ndodhjen e një ngjarje të Forcës Madhore dhe:

11.8.1 Pala e Prekur nuk do të pretendojë asnjë lehtësim për/apo në lidhje me një ngjarje të Forcës Madhore, përveçse kur ajo ka njoftuar Palën tjetër me shkrim mbi ndodhinë e një ngjarje të Forcës Madhore, sa më shpejt që ka qenë e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe në çdo rast, brenda 7 (shtatë) ditëve pasi Pala e Prekur të ketë ditur apo duhet në mënyrë të arsyeshme të dinte për ndodhinë e saj dhe pasojat e mundshme materiale, që



kjo Ngjarje e Forcës Madhore, ka të ngjarë të ketë mbi detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate.



11.8.2 Çfarëdo njoftimi në pajtim me Nenin 11.8 do të përfshijë edhe të gjitha hollësitë e plota të:

- (a) natyrës dhe shtrirjes së secilës ngjarje të Forcës Madhore, e cila është objekt i çdo pretendimi për lehtësim sipas Nenit 11 me provat mbështetëse për këtë;
- (b) kohëzgjatjen e vlerësuar dhe/apo pasojën e mundshme që ka apo do të ketë ngjarja e Forcës Madhore mbi përmbushjen nga ana e Palës së Prekur të detyrimeve të saj, sipas kësaj Kontrate;
- (c) masat që po merr Pala e Prekur apo që ajo propozon të merren, për të lehtësuar pasojën e kësaj ngjarje të Forcës Madhore; dhe
- (d) çdo informacion tjetër me rëndësi për pretendimin e Palës së Prekur.

11.8.3 Për aq sa Pala e Prekur vazhdon të pretendojë se është prekur nga kjo ngjarje e Forcës Madhore, ajo do t'i japë Palës tjetër raporte të rregullta me shkrim (jo më pak se sa një herë në javë) me informacion siç kërkohet nga Neni 11.8 dhe informacione të tjera, siç mund në mënyrë të arsyeshme të kërkohen që të sigurohen nga Pala e Prekur.

## 11.9 Përjashtimi nga detyrimi për përmbushje

Nëse Pala e Prekur bëhet tërësisht apo pjesërisht e paaftë që të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një ngjarje të Forcës Madhore, ajo do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve të saj në masën që ajo është e paaftë të përmbushë për shkak të kësaj Ngjarje të Forcës Madhore, me kusht që:

- (i) pezullimi i përmbushjes të mos jetë me qëllim më të gjerë dhe kohëzgjatje më të madhe se sa kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga kjo ngjarje e Forcës Madhore;
- (ii) Pala e Prekur do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme, që të ulë apo kufizojë dëmet ndaj Palës tjetër, që vijnë nga apo si rrjedhojë e ekzistencës apo ndodhjes së kësaj ngjarje të Forcës Madhore dhe për ta rregulluar atë me kujdesin e duhur; dhe
- (iii) kur Pala e Prekur është në gjendje që të rifillojë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, ajo do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim për këtë dhe do të rifillojë menjëherë përmbushjen e detyrimeve të saj, të përcaktuara këtu.

## KREU VI

### MOSPËRMBUSHJET DHE ZGJIDHJA E KONTRATËS

#### Neni 12

#### Mospërmbushja







## 12.1 Mospërbushja

Nënkupton Mospërbushjen e Konçesionarit ose Mospërbushjen e BT-së, ose të dyja siç mund të pranohet apo kërkohet nga konteksti.

### 12.1.1 Mospërbushja e Konçesionarit

Ngjarjet në vijim do të përbëjë ngjarje të mospërbushjes së Konçesionarit (secila një "**Mospërbushje të Konçesionarit**") përveçse kur një ngjarje e tillë ka ndodhur si rrjedhojë e Mospërbushjes së BT ose një ngjarje e Forcës Madhore):

- (a) Konçesionari nuk arrin të fillojë Punimet e Ndërtimit brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga Data e Fillimit;
- (b) Konçesionari dështon në përbushjen e detyrimeve të tij sipas Nenit 10.3 të Kontratës;
- (c) Çdo deklaram apo garanci e dhënë nga Konçesionari sipas kësaj Kontrate zbulohet se është i rremë apo i gënjeshtërt;
- (d) Konçesionari vendos Barrë në Vendndodhjen e Projektit në favor të cilitdo person; në kundërshtim me 5.1.2 (r).
- (e) Konçesionari transferon pa miratimin e BT-së aksionet/kuotat e Shoqërisë Konçesionare;
- (f) Transferimi, pa miratimin e BT i (i) të drejtave dhe/ose detyrimeve të Konçesionarit sipas cilësdo kontrate të Projektit, ose (ii) i të gjithë apo i një pjese materiale të të drejtave të Konçesionarit, përveçse atje ku ky transferim, sipas mendimit të arsyeshëm të BT, nuk prek aftësinë e Konçesionarit që të përbushë detyrimet dhe Konçesionari ka kapacitetin financiar dhe teknik që të përbushë detyrimet e tij materiale sipas kontratave të Projektit;
- (g) Ortaku/ët e Konçesionarit/Shoqërisë Konçesionare marrin një vendim për likuidimin vullnetar Konçesionarit/të Shoqërisë Konçesionare;
- (h) Një kërkesë për mbylljen e aktivitetit të Konçesionarit pranohet nga një autoritet apo gjykatë kompetente, ose Konçesionari urdhërohet prej tyre të mbyllë aktivitetin, përveçse për qëllimin e bashkimit të ;
- (i) Ka ndodhur mospërbushje sipas Dokumenteve të Financimit dhe cilido nga Palët Financuese, ka tërhequr mbështetjen e tij financiare dhe ka kërkuar pagesën e shumave sipas Dokumenteve të Financimit dhe Konçesionari nuk ka mundur të sigurojë financimin e Projektit;
- (j) Konçesionari pezullon apo braktis operimet e Projektit për një periudhë jo më pak se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, ku kjo nuk është si një rrjedhojë e një ngjarje të Forcës Madhore;





- (k) Konçesionari nuk njej zbatimin e kësaj Kontrate ose provon se nuk dëshiron t'i nënshtrohet parashikimeve të kësaj Kontrate;
- (l) Konçesionari ka vonuar çfarëdolloj pagese që ka qenë i detyruar të bëjë sipas kësaj Kontrate dhe nëse kjo vonesë kalon 90 (nëntëdhjetë) ditë;
- (m) Konçesionari kryen një Shkelje Materiale të kësaj Kontrate.

#### 12.1.2 Mospërmbushja e BT

Ngjarjet në vijim do të përbëjnë ngjarje të mospërmbushjes së BT (secila një "**Mospërmbushje të BT-së**"), përveçse kur cilado Ngjarje e tillë e Mospërmbushjes së BT, ka ndodhur si rrjedhojë e Mospërmbushjes së Konçesionarit ose e një ngjarje të Forcës Madhore.


- (a) BT nuk përmbush detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe nuk ka arritur ta eliminojë këtë mospërmbushje brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të Konçesionarit;
- (b) BT nuk njej zbatimin e kësaj Kontrate ose provon se nuk dëshiron të përmbushë parashikimet e kësaj Kontrate;
- (c) BT ka krijuar përmes një veprimi apo mosveprimi, rrethana që kanë një Pasoje Materiale të Padëshiruar mbi përmbushjen e detyrimeve të Konçesionarit dhe nuk ka arritur ta eliminojë këtë pasojë brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga njoftimi përkatës i Konçesionarit.

### 12.2 Zgjidhja për shkak të Ngjarjes së Mospërmbushjes

#### 12.2.1 Zgjidhja për Mospërmbushjen e Konçesionarit

- (a) Pa cënuar cilëndo të drejtë apo rregullim tjetër që mund të ketë BT sipas kësaj Kontrate, pasi ndodh një Mospërmbushje e Konçesionarit, BT do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë duke lëshuar një Njoftim Zgjidhje ndaj Konçesionarit, me kusht që përpara lëshimit të Njoftimit të Zgjidhjes, BT të informojë me njoftim me shkrim Konçesionarin mbi qëllimin e saj për të lëshuar Njoftimin e Zgjidhjes së Kontratës ("**Njoftimi Paraprak**").
- (b) Në rast se shkelja/mospërmbushja kryesore nuk eliminohet brenda një periudhe prej 60 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e Njoftimit Paraprak ("**Periudha e Rregullimit**"), BT do të ketë të drejtë që të arkëtojë menjëherë Sigurimin e Kontratës në masën që kjo është e nevojshme për të mbuluar kosto apo dëme të ardhura nga shkelja/mospërmbushja e Konçesionarit, duke i dhënë njoftim Konçesionarit ("**Njoftimi i Arkëtimit**").
- (c) Nëse mospërmbushja nuk eliminohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Njoftimi i Arkëtimit dhe nuk sigurohet një Sigurim i ri i Kontratës brenda së njëjtës periudhë në përputhje me Nenin 3, BT do të ketë të drejtë të lëshojë Njoftimin e Zgjidhjes.



- 
- (d) Sa vijon do të zbatohet në lidhje me rregullimin e çfarëdo nga pakujdesitë dhe/ose shkeljet e kësaj Kontrate:
- (i) Periudha e Rregullimit e parashikuar në këtë Kontratë nuk do të çlirojë Konçesionarin nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga shkelja apo pakujdesia e tij;
  - (ii) Periudha e Rregullimit nuk do të zgjatet në asnjë mënyrë nga asnjë periudhë pezullimi e parashikuar sipas kësaj Kontrate;
  - (i) Nëse rregullimi i çfarëdo shkelje nga ana e Konçesionarit kërkon çfarëdo veprimi të arsyeshëm nga Konçesionari që duhet miratuar nga BT ose çdo autoritet shtetëror të parashikuar këtu, Periudha e Rregullimit e zbatueshme, do të zgjatet për aq sa është periudha që i duhet BT ose agjencisë shtetërore për të dhënë miratimin e kërkuar.

#### 12.2.2 Zgjidhja për Mospërmbushjen e BT-së

- (a) Nëse Konçesionari pretendon një Mospërmbushje të BT-së, duhet të lëshojë një Njoftim Paraprak për BT-në, me qëllim eliminimin e shkeljes/mospërmbushjes kryesore, brenda një periudhe prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e Njoftimit Paraprak (“**Periudha e Rregullimit**”), duke plotësuar kërkesat e pikës 12.3 më poshtë.
- (b) Në rast se shkelja/mospërmbushja kryesore nuk eliminohet brenda afatit të përcaktuar më sipër, Konçesionari do të ketë të drejtë që të zgjidhë këtë Kontratë duke lëshuar Njoftimin e Zgjidhjes dhe duke kërkuar pagesën e të gjitha dëmeve të shkaktuara nga zgjidhja e kësaj Kontrate në pajtim me Nenin 21.

### 12.3 Njoftimet e Palëve

Secila nga Palët që pretendon mospërmbushje dhe kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimet duhet të përmbajnë por nuk kufizohen si më poshtë:

12.3.1 Detajet e dhura duke nënvizuar shkaku e mospërmbushjes dhe të zgjidhjes;

12.3. Afatin për korrigjimin e Mospërmbushjes, si dhe veprimet/masat që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;

12.3.3 Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i mospërmbushjes dhe i zgjidhjes së kontratës;

12.3.4 Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

### Neni 13 Të drejtat e BT pas Zgjidhjes

13.1 Pas Zgjidhjes së kësaj Kontrate për çfarëdo arsye qoftë, BT do të ketë fuqinë dhe autoritetin për të:



- 13.1.1 Marrë menjëherë në zotërim dhe nën kontroll pasuritë e Projektit;
- 13.1.2 Ndaluar Konçesionarin dhe çdo person që pretendon përmes apo për Konçesionarin, që të hyjë në Pasuritë e Projektit, të merret me to apo cilëndo pjesë të tyre;
- 13.1.3 Zëvendësojë Konçesionarin, pa nevojën e ndonjë veprimi të mëtejshëm nga Konçesionari, në kontratat e Projektit sipas vlerësimit të BT, me fuqi që nga data e komunikimit të një zgjedhje të tillë ndaj palës/ve të kontratave përkatëse, duke pasur parasysh që çfarëdo shumash të pretenduara nga këto palë si detyrim për punën dhe shërbimet e kryera apo që po kryhen për shkak të çdo veprimi, mosveprimi apo ngjarje përpara kësaj date zgjedhjeje, do të jenë në ngarkim të Konçesionarit dhe BT nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse për shumën të tillë.  
Konçesionari do të sigurojë që kontratat e Projektit të përmbajnë dispozita të nevojshme për zbatimin e parashikimeve të këtij Neni.
- 13.2 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës, nuk çliron Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të Mjedisit të Projektit tek BT. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes së Kontratës.  
Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Konçesionari, atëherë BT ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e Mjedisit të Projektit, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

#### **Neni 14**

#### **Të drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i Konçesionarit**

##### **14.1 Njoftimi i Palëve Financuese**

14.1.1 Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje thelbësore nga ana e Konçesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës, BT përveç njoftimit të Konçesionarit sipas pikës 12.3 të kësaj Kontrate, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar Konçesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë.

14.1.2 Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmë të arsyeshme për këtë qëllim.

##### **14.2 Zëvendësimi i Konçesionarit**

14.2.1 Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Konçesionari brenda afatit të përcaktuar më lart, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes), zgjedh të ndërhyjë duke i propozuar BT-së, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barazvlefshme me atë të Konçesionarit.



- 14.2.2 Në lidhje me sa më sipër, BT nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash, në lidhje me Palët Kontraktuese. Zëvendësuesi do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Konçesionarit.
- 14.2.3 Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e Projektit, kontrata do të zgjidhet.
- 14.2.4 Në rast të një mospërmbushje të Konçesionarit sipas Dokumenteve të Financimit, Pala/ët Financuese mund t'i kërkojnë BT zëvendësimin e Konçesionarit. Në këtë rast aplikohen dispozitat e mësipërme.
- 14.2.5 Për të shmangur paqartësi, zëvendësimi i Konçesionarit sipas këtij neni nuk do të konsiderohet si Konçesionari i ri në kuptim të Legjislacionit të Zbatueshëm në lidhje me procedurat konkurruese, dhe nuk do t'i nënshtrohet këtyre të fundit.


## **KREU VII DORËZIMI DHE TRANSFERIMI**

### **Neni 15 Dorëzimi i Pasurive të Projektit**

- 15.1 Pas mbarimit të koncesionit për shkak të kalimit të kohës dhe në ecurinë normale të tij, Koncesionari, në fund të Periudhës së Koncesionit, bën dorëzimin e zotërimit/posedimit të qetë tek BT sipas Shtojcës 5.

### **Neni 16 Transferimi i Aseteve**

- 16.1 Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë Periudhës së Koncesionit si dhe çdo titull mbi to. Procesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit, me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, sipas përcaktimit të bërë në nenin 17.
- 16.2 Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:
- a) Mjedisin e Projektit dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
  - b) Ndërtesa, makineri, paisje;
  - c) Pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
  - d) Të drejtat kontraktore;
  - e) Dorëzimin e librave, dokumenteve dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
  - f) Çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj Kontrate.

- 
- 16.3 Konçesionari duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura/dhe në gjendje të mirë pune, në respektim të normave vjetore të amortizimit sipas përcaktimeve në Legjislacionin e Zbatueshëm. Në rast se Kontrata është zgjidhur për shkak të Forcës Madhore, Konçesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve, ka ardhur si pasojë direkte e saj.
- 16.4 Çdo e drejtë që Konçesionari ka fituar me këtë Kontrate, do të mbarojë me transferimin e Projektit, përveç të drejtave që i mbijetojnë kësaj Kontrate.
- 16.5 Kostot e transferimit të Projektit do të përballohen nga Konçesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të BT-së.

#### **Neni 17**

#### **Inspektimi i përbashkët dhe eliminimi i të metave**

- 17.1 Proçesi i dorëzimit fillon të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit, nëpërmjet një inspektimi të përbashkët nga përfaqësues të BT, Inxhinieri të Pavarur dhe Koncesionarit.
- 17.2 Përfaqësuesit e BT dhe Inxhinieri i Pavarur, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga ky inspektim, përgatisin dhe sigurojnë për Koncesionarin një listë të punimeve/shtesave/ndryshimeve nëse ka, që duhen bërë për ta sjellë Projektin në nivelin e parashikuar të kushteve të shërbimit, sipas amortizimit të Investimit në tërësi dhe pas ri-investimit në përputhje me vlerat e përcaktuara në nenin 2.4 të paktën 3 (tre) muaj përpara datës së mbarimit të periudhës së koncesionit.
- 17.3 Në rast se Koncesionari nuk arrin që të kryejë punimet e mësipërme brenda periudhës kohore të përcaktuar, BT mund të vendosë që t'i zbatojë këto punime nëpërmjet një personi tjetër të zgjedhur nga BT në mënyre të arsyeshme dhe sipas kushteve të tregut, me riskun dhe kostot e Koncesionarit.
- 17.4 Çdo kosto që i është shkaktuar BT në lidhje me këtë, do të rimbursohet nga koncesionari ndaj BT brenda 7 (shtatë) ditësh nga marrja e kërkesës nga Koncesionari.
- 17.5 Në rast se këto kosto nuk rimbursohen nga Konçesionari brenda afatit të sipërpërmendur, BT do të ketë të drejtën të përfitojë shumën/at përkatëse nga Sigurimi i Kontratës në masën që kjo është e nevojshme për mbulimin e kostove sipas këtij Neni.

### **KREU VIII SANKSIONET**

#### **Neni 18**

#### **Përcaktimi dhe vendosja e sanksioneve**



18.1 Në rast të mosrespektimit të afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, BT ka të drejtë të penalizojë Koncesionarin si më poshtë:



- (i) BT njofton menjëherë me shkrim Koncesionarin për mospërbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të Kontratës, duke i caktuar një afat të arsyeshëm për eliminimin e mospërbushjes dhe pasojave të saj (“**Periudha e Faljes**”) i cili në cdo rast do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më shumë se 60 (nëntëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga Koncesionari;
- (ii) Periudha e Faljes nuk do të llogaritet në zbatimin e sanksioneve/penalitetëve, në kuptim të kësaj Kontrate.
- (iii) Sanksionet/penalitetet do të zbatohen nga dita e nesërme e përfundimit të Periudhës së Faljes.
- (iv) BT mund të zgjidhë Kontratën në rast se pas 6 (gjashtë) muajve nga data e zbatimit të sanksioneve/penalitetëve nga BT, Koncesionari nuk ka përmbushur detyrimin/et e tij sipas Kontratës, përveç rasteve kur kjo mospërbushje ka ardhur për shkaqe jashtë kontrollit të Koncesionarit.

18.1.1 Në përputhje me parashikimet e këtij neni, për çdo shkelje të detyrimeve të Koncesionarit për të cilat parashikohen afate në këtë Kontratë, Koncesionari penalizohet me 10.000 (dhjetëmijë) lekë për çdo ditë vonesë, përveç kur është parashikuar ndryshe në dispozitën përkatëse të Kontratës.

18.2 Sanksionet do të llogariten çdo fund Viti Financiar, sipas një akt-rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

18.3 Llogaritja e çdo sanksioni, do të bëhet duke pasur parasysh Njoftimin e bërë nga BT për shkeljen.

18.4 Sanksionet paguhën në llogari të BT. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, BT i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi duke njoftuar me shkrim Koncesionarin nga data e fillimit të llogaritjes së sanksionit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet nga Koncesionari brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i kërkesës me shkrim të BT, ky i fundit ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor, të kërkojë edhe kamatat ligjore.

18.5 Në asnjë moment BT nuk ka të drejtë të kërkojë sanksione në rast se ajo nuk ka dërguar Njoftimin për mospërbushjen tek Koncesionari dhe për sa kohë Koncesionari ka eliminuar mospërbushjen përgjatë Periudhës së Faljes, apo në rast se kjo mospërbushja përgjatë Periudhës së Faljes ka ardhur si pasojë e Forcës Madhore.

## KREU IX TE NDRYSHME



**Neni 19**  
**Ndryshimi në Ligj**



- 19.1 Nëse si rrjedhim i një Ndryshimi në Ligj, Konçesionari pëson një rritje në kosto apo pakësim në bilancin neto pas taksimit apo barrë të tjera, Konçesionari mund të njoftojë me shkrim BT dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Konçesionari, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky Ndryshim në Ligj, që ka sjellë si rrjedhim këtë rritje të kostove, pakësim në kthimet e investimit apo barrë tjetër financiare. BT do ti komunikojë me shkrim Konçesionarit qëndrimin e saj në lidhje me pranimin ose refuzimin e propozimit të Konçesionari për ndryshim të Kontrates si rrjedhojë e Ndryshimit në Ligj, brenda 45 (dyzetepesë) ditësh nga data e njoftimit të Konçesionarit.
- 19.2 Palët bien dakord se BT nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme ndryshime të kësaj Kontrate të propozuara nga Konçesionari, në mënyrë që Konçesionari të ruajë pozitën financiare që gëzonte përpara ngjarjes së Ndryshimit në Ligj.

**Neni 20**  
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 20.1 Përveçse ku deklarohej shprehimisht ndryshe në këtë kontratë, çdo mosmarrëveshje, përfshirë edhe mospërfundimin e Projektit, ndërmjet palëve dhe e njoftuar me shkrim nga cilado palë ndaj tjetrës ("**Mosmarrëveshja**"), në hapin e parë do të tentohet të zgjidhet me mirëkuptim nga Grupi Drejtues, i cili duhet të shprehet për këtë mosmarrëveshje brenda 45 (dyzetepesë) ditëve.
- 20.2 Palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente në Republikën e Shqipërisë brenda 30 ditëve:
- 20.2.1 Nga dita e marrjes së njoftimit për vendimin e Grupi Drejtues; ose
- 20.2.2 Nga përfundimi i afatit 45 (dyzetepesë) ditor në rastet kur Grupi Drejtues, duhet të ishte shprehur.

**Neni 21**  
**Përgjegjësia dhe Dëmshpërblimi**

- 21.1 Dëmshpërblimi i përgjithshëm:
- 21.1.1 Koncesionari do të dëmshpërblejë BT ndaj çdo dhe nga të gjitha procedimet, veprimet dhe pretendimet e palëve të treta që rrjedhin nga një shkelje e bërë nga Koncesionari, ndaj cilitdo nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, përveçse në masën që një pretendim i tillë ka ardhur për shkak të Mospërmbushjes së BT;







- 21.1.2 BT do të dëmshpërblejë Koncesionarin nga dhe kundrejt të gjitha procedimeve, veprimeve dhe pretendimeve të palëve të treta për humbje, dëmtime dhe shpenzime të çfarëdo lloji dhe natyre, që burojnë nga mangësitë në titullin apo të drejtat e BT-së apo nga Mospërmbushja nga ana e BT, zyrtarëve të saj, nëpunësve apo agjentëve të BT të detyrimeve të BT sipas kësaj Kontrate, përveçse në masën kur pretendime të tilla kanë ardhur për shkak të Mospërmbushjes së Koncesionarit.
- 21.2 Në përputhje me këtë nen, Koncesionari do të dëmshpërblejë BT nga dhe kundrejt një apo të gjitha humbjeve dhe dëmeve që burojnë nga mospërmbushja e detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, përveçse në masën kur pretendime të tilla kanë ardhur për shkak të Mospërmbushjes së BT.
- 21.3 Në përputhje me këtë nen, BT do të dëmshpërblejë Koncesionarin ose Shoqërinë Koncesionare nga dhe kundrejt një apo të gjitha humbjeve dhe dëmeve, që burojnë nga mospërmbushja e detyrimeve të BT sipas kësaj kontrate, përveçse në masën kur pretendime të tilla kanë ardhur për shkak të Ngjarjes së Mospërmbushjes së Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.
- 21.4 Në përputhje me këtë nen, Koncesionari do të dëmshpërblejë BT kundrejt dëmeve që mund të pësojë e paguajë BT, në lidhje me pretendime, padi apo procedime që rrjedhin nga pretendime të cënimit të cilësdo të drejte të brendshme apo ndërkombëtare patente, të drejte autori ose pronësie tjetër intelektuale, apo të drejte konfidencialiteti në lidhje me çfarëdo material, informacioni, projekti ose procesi të përdorur nga Koncesionari ose nga nënkontraktorët e Koncesionarit, në përmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit ose në çfarëdo mënyre të përfshira në/ose të lidhura me Projektin. Nëse nën çfarëdo padie, pretendimi apo pretendimesh të tilla, lëshohet një urdhër i përkohshëm kufizimi i të drejtave të BT ose një vendim i ndërmjetëm, Koncesionari ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet për të siguruar ndjekjen e të gjitha shkallëve të ankimit, me qëllim pezullimin dhe anulimin e këtij vendimi apo urdhri.

## Neni 22

### Vazhdimësia e detyrimeve

- 22.1 Zgjidhja e kësaj Kontrate nuk çliron Koncesionarin apo BT nga asnjë prej detyrimeve të këtushme, të cilat në mënyrë të shprehur ose jo, nuk preken nga zgjidhja e saj.
- 22.2 Përveçse kur parashikohet ndryshe, zgjidhja e kësaj Kontrate nuk do të çlirojë asnjërin Palë nga detyrimi apo përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin e Palës tjetër, që vjen apo është shkaktuar nga veprime apo mosveprime të kësaj Pale të kryera përpara hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhje apo që buron nga kjo zgjidhje.

## Neni 23

### Dispozita për Ruajtjen e Fuqisë së Kontratës





Nëse për çfarëdolloj arsye, cilado dispozitë e kësaj kontrate është apo bëhet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ose shpallet me akte që përbëjnë titull ekzekutiv, nga cilado gjykatë e juridiksionit kompetent apo çdo autoritet tjetër se është e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të preken nga palët, të cilat negociojnë në mirëbesim me pikësynimin që të bien dakord mbi një apo më shumë dispozita, të cilat mund të zëvendësojnë këto dispozita të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, sa më shpejt që të jetë e mundur. Me kusht që, mosarritja e rënies dakord mbi këto dispozita nuk do t'i nënshtrohet zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sipas kësaj kontrate ose ndryshe.

#### **Neni 24** **Të Drejtat, Mjetet Ligjore dhe Heqja Dorë**

- 24.1 Mosushtrimi apo çdo vonesë në ushtrimin e çdo të drejte, kompetence apo mjeti ligjor nga secila Palë në lidhje me çdo mospërbushje sipas kësaj Kontrate apo çdo marrëveshje tjetër nuk do të paragjykojë të drejtat, kompetencat apo mjetet ligjore të tjera të kësaj Palë apo nuk do të quhet si heqje dorë prej tyre apo dhënie pëlqimi për heqje dorë prej tyre. Ushtrimi i vetëm njëerës apo ushtrimi i pjesshëm i të drejtave, kompetencave apo mjeteve ligjore nuk ndalon ushtrimin e mëtejshëm të tyre apo ushtrimin e të drejtave, kompetencave apo mjeteve ligjore të tjera. Veprimet e secilës Palë në lidhje me një mospërbushje apo pranimi i kësaj mospërbushje nuk do të çenojnë apo nuk do të paragjykojnë të drejtat, kompetencat apo mjetet ligjore të kësaj Palë për të vepruar në lidhje me raste të tjera të mospërbushje.
- 24.2 Heqja dorë nga secila Palë nga çdo e drejtë sipas kësaj Kontrate apo sipas Legjislacionit të zbatueshëm, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar në mënyrën e duhur nga një Palë e tillë. Një e tillë heqje dorë nuk do të veprojë dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga të drejta, pretendime apo mjete ligjore vijuese të Palës, dhe nuk do të prekë në asnjë mënyrë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e kësaj Kontrate.

#### **Neni 25** **Ligji i zbatueshëm**

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 26** **Ndryshimet**

Kjo Kontratë dhe Shtojcat e saj, përbëjnë Kontratën e plotë të arritur ndërmjet Palëve dhe çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate, do të kryhet me miratimin e përbashkët me shkrim të Palëve.



**Neni 27  
Njoftimet**



- 26.1 Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet Palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.
- 26.2 Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet BT-së nga Konçesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon, në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.
- 26.3 Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

A. Për Autoritetin Kontraktues

Bashkia e Tiranës

Enton Punavia – Drejtor, Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor.  
Adresa: Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë – Shqipëri

B. Për Konçesionarin

Shoqëria “Taiwan sh.p.k.”

Avni Braçaj

ose ato persona dhe adresa, që mund të njoftohet në mënyrën e duhur nga Palët përkatëse kohë pas kohe dhe do të vlerësohet se janë bërë apo dërguar në rastin e çfarëdo komunikimi të bërë me shkrim, kur dorëzohet me anë të postës rekomade me kthim pergjigje në atë adresë.

**Neni 28  
Gjuha**

Të gjitha njoftimet e kërkuara për t'u dhënë sipas kësaj Kontrate dhe të gjitha komunikimet, dokumentet dhe procedimet të cilat mund të jenë në çfarëdolloj mënyre me rëndësi për këtë Kontratë, do të bëhen me shkrim në gjuhën shqipe.





**Neni 29**  
**Konfidencialiteti**

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj Kontrate.

**Neni 30**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët, përpara noterit.

**Neni 31**  
**Rregjistrimi i Kontratës**

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e saj në fuqi, kjo Kontratë duhet të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

\*\*\*

Kjo Kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje me vlerë të njëjtë secila, në gjuhën shqipe dhe pasi iu lexua Palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë Noterja, e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

Nënshkruar, vulosur

Për **BASHKINË ETIRANËS**

Erion Veliaj - Kryetar

*Erion Veliaj*  
(emër, mbiemër, firmë)

Për **KONÇESIONARIN**

Avni Braçaj - Administrator i Përgjithshëm

*Avni Braçaj*  
(emër, mbiemër, firmë)



**NOTER**

(Emri)

NOTERE  
DENISA M. ÇELA



LISTA E SHTOJCAVE

- |           |  |
|-----------|--|
| Shtojca 1 | Çështje Financiare                             |
| Shtojca 2 | Çështje Teknike                                |
| Shtojca 3 | Programi i Përfundimit të Projektit            |
| Shtojca 4 | Provat dhe Testimet                            |
| Shtojca 5 | Vendndodhja dhe Dorëzimi                       |
| Shtojca 6 | Inxhinieri i Pavarur                           |
| Shtojca 7 | Kërkesat Minimale të Operimit dhe Mirëmbajtjes |



Plani i tarifimit do të jetë si më poshtë:

Tarifa e parkimit	Ora e parë 120 Lekë	
	Nga ora e dytë deri në orën e katërt Lekë / ½ ore	50
	Nga ora e katërt deri në orën e tetë Lekë / ½ ore	40
	Nga ora e tetë deri në orën e dymbëdhjetë Lekë / ½ ore	40
Tarifa e posaçme e parkimit për kategori të veçanta	Invalid	Falas
	Institucione publike	6.000 Lekë / muaj
	Rezident	10.000 Lekë / muaj
	Biznesi	12.000 Lekë / muaj

Plani i tarifave duhet të shfaqet qartë në hyrje të parkimit nëntokësor, në matësit e parkimit dhe në zonat kryesore që çojnë tek vendet e parkimit në rrugë.



## SHTOJCA 2

### ÇËSHTJE TEKNIKE

#### A. Projekt - Zbatimi

Projekt-zbatimi do të zhvillohet nga Konçesionari në përputhje me Projekte - Idenë e paraqitur prej tij, pjesë e Dokumentave Standard të Tenderit ("DST").

Pa çënuar specifikat teknike të përcaktuara në DST dhe duke konsideruar planet e transportit dhe zhvillimit urban rreth sheshit Skënderbej, BT dhe Konçesionari do të shqyrtojnë dhe eventualisht rishikojnë zgjidhjet teknike të "hyrjeve/daljeve" në parkimin nëntokësor të parashikuara në Projekt/et.

Palët do të diskutojnë dhe bien dakord mbi ndryshimet eventuale brenda 15 (pesëmbdhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate.

Palët do të bashkëpunojnë për identifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshem për pajisjen me leje ndërtimi nga KKT. Konçesionari do të paraqes kërkesën pranë KKT-së.

#### B. Specifikimet TIK

Sikurse përcaktuar në DST, janë nënsistemet e mëposhtme, të cilat duhen integruar plotësisht me njëri-tjetrin, nëpërmjet Dhomës së Kontrollit,

- Sistemi i Pagesave;
- Sistemi i Kontrollit të Hyrjes (Aksesit);
- Sistemet e Disponueshmërisë dhe Udhëzuesi i Pakimit të Brendshëm;
- Sistemi i Informacionit;
- Sistemi i Menaxhimit;
- Sistemi Dhomës së Kontrollit.

Për sistemin e pagesave, do të ketë akses edhe personi i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa Sistemi i Disponueshmërisë do të jetë i lidhur me Qendrën e Monitorimit e Menaxhimit të Sistemeve të Trafikut (MMST).

#### C. Aspektet teknologjike

Sikurse përcaktuar në DST, parkimi nëntokësor duhet të pajiset me një seri nënsistemesh të afta për të realizuar disa funksione.

- (i) Sistemi i pagesave, i cili duhet të sigurohet nëpërmjet metodave të mëposhtme:
- në të holla,
  - makineri për shitjen e biletave (brenda dhe jashtë parkingut),





- makineri për shitjen e biletave (brenda dhe jashtë parkingut),
- makineri për karta krediti dhe debiti (si në hyrjen kryesore dhe tek makineri e shitjes),
- Shitje dhe pagesë përmes Internetit për abonimet
- SMS (duke përdorur gjithashtu sistemin e koduar).

(ii) Sistemi i kontrollit të hyrjes, i cili duhet të jetë i aftë për të menaxhuar hyrjen në parkim dhe për të nxjerrë numrin e parkimit në dispozicion në kohë reale. Ky informacion duhet të përdoret edhe për çështje të menaxhimit. Dizajnimi i sistemit duhet të marrë parasysh të gjitha çështjet e shpëtimit dhe të sigurisë të përfshira në një sistem të kontrollit të hyrjes.

(iii) Disponueshmëria dhe sistemi udhëzues i parkingut të brendshëm, i cili duhet të jetë në gjendje të:

- menaxhojë disponueshmërinë / jodisponueshmëria për secilin prej vendeve të parkimit
- të përdorë këtë informacion në mënyrë që të udhëzojë shoferët drejt vendit më të afërt të disponueshëm.

Ky informacion duhet të jepet për secilin vendparkimi dhe duhet të përmblihet në çdo nivel kat.

Shenja të veçanta duhet të sigurohen për parkimin e rezidentëve dhe personave me aftësi të kufizuara (niveli etj.)

(iv) Sistemi i informacionit duhet të jetë një sistem i posaçëm informacioni i aftë të ofrojë mesazhe të llojeve të ndryshme (vende parkimi në dispozicion, rastet e veçanta, të dhëna të tjera, etj.) përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit / të brendshme dhe të jashtme, menjëherë dhe në sisteme në largësi:

- Sistem të brendshëm të menaxhimit të parkimit siç është përmendur mësipër
- Mbikëqyrës të Lëvizshmërisë në Dhomën e Kontrollit (shkalla e zënies në kohë reale dhe koha reale e rrjedhjedhës hyrëse dhe dalëse të trafikut)
- Shenja mesazhesh që variojnë të drejtuara nga në Dhoma e Kontrollit (mesazhe në lidhje me mos-disponueshmërinë e vendeve të parkimit)
- Platforma e informimit të lëvizshëm (shkalla e zënies në kohë reale)
- Sistem informacioni me SMS (shërbim lajmërimi në rastin e mos-disponueshmërisë së vendeve të parkimit)

#### D. Sistemi i menaxhimit

Sikurse përcaktuar në DST, parkimi nentokësor duhet të pajiset me një sistem të menaxhimit të brendshëm i aftë të:

- mbledhë të dhëna nga sistemi i pagesës
- mbledhë të dhëna sistemet e kontrollit të hyrjes dhe të numërimit
- mbledhë lajmërimet dhe alarmet e nxjerra nga funksionet e nën- sistemit dhe pajisjet vetë-diagnostikuese dhe të lejojë të drejtojnë difektet kryesore
- krijojë raporte të menaxhimit





- drejtojë të gjitha çështjet e kontabilitetit në lidhje me gjithë drejtimin e parkingut (hyrjet në të holla, lidhjet e transaksioneve me bankat/kartat e kreditit,..)

#### **E. Dhoma e kontrollit**

Sikurse përcaktuar në DST, Konçesionari duhet të sigurojë një dhomë qendrore e menaxhimit të parkimit për:

- kontrollin nga larg të gjitha sistemeve dhe pajisjeve të lidhura me parkim
- sportetlin e informacionit për klientin në rast të problemeve me sistemin e pagesave apo të sistemit të kontrollit të aksesit

**F.** Sikurse përcaktuar në DST, Konçesionari ka të drejtë të shfrytëzojë funksionalisht parkimin nëntokësor përmes:

- administrimit të vendeve të parkimit që i kushtohen qëndrimit të përkohshëm, sipas planit tarifor të përcaktuar në Shtojcën nr. 1;
- administrimit të vendeve të parkimit që i kushtohen lejeve të kalimit të posaçëm apo abonimeve, sipas planit tarifor të përcaktuar në Shtojcën nr. 1;

Është e ndaluar zënia e zonave dhe hapësirave publike që nuk janë shprehimisht të përfshira në Projekt, pa sqaruar arsyet për të cilat bëhet dhe pa marrë aprovimin e BT.



### SHTOJCA 3

#### Programi i Përfundimit të Projektit



- 1.1 Punimet e Ndërtimit parashikohet të kryhen në bazë të “Organizimi i Punimeve sipas Grafikut Linear” këtu bashkëlidhur (“Grafiku i Punimeve”). Grafiku i Punimeve dhe preventivi i punimeve mund të pësojnë ndryshime gjatë miratimit të lejes së ndërtimit për zbatimin e Projektit në KKT, të cilat do të konsiderohen automatikisht të vlefshme dhe të efektshme nga Palët dhe pjesë përbërse e Shtojcës 3.
- 1.2 Konçesionari, jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë përpara përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut të Punimeve do të përgatisë dhe do t’i paraqes Inxhinierit të Pavarur grafikun e punimeve të mbetura (si për shembull, por pa u kufizuar tek instalimi i pajisjeve etj.), i cili gjithësesë nuk duhet të tejkaloj afatin e përcaktuar në Kontratë për arritjen e DOT (“Grafiku i Instalimeve”).
- 1.3 Në kuptim të kësaj Shtojce, Grafiku i Punimeve dhe Grafiku i Instalimeve do të përbëjnë sëbashku Programin e Programi i Përfundimit të Projektit.

